



# Arsyeja dhe Filorofia

NË KËNDVËSHTRIMIN ISLAM



Osman Nuri Topbash

PROGRESI  
BOTIMI





Shkodër / 2014

**Titulli original:** *İslâm nazarında*  
AKIL VE FELSEFE

**Përktheu:** Albert Halili  
**Redaktor:** Zija Vukaj  
**Korrektor:** Dr. Irida Hoti  
**Kryeredaktor:** Alban Kali  
**Design:** Bledar Xama



**PROGRESI** sh.p.k. \_\_\_\_\_

Adresa: Sheshi "2 Prilli" / Rr: Studenti / Shkodër / Shqipëri  
Mob: +355 67 60 78484  
http: [www.progresibotime.com](http://www.progresibotime.com) e-mail: [botime@progresibotime.com](mailto:botime@progresibotime.com)

Adresa Kosovë: Rr: Ardian Zurnaxhiu / pn. Ralin / Prizren  
Tel: +381 29 222 795  
Fax: +381 29 222 797 e-mail: [kosova@progresibotime.com](mailto:kosova@progresibotime.com)

Adresa Maqedoni: Rr: Stiv Naumov / nr. 9 / lokal 25 / Shkup  
Tel: +398 71 956 271 e-mail: [maqedoni@progresibotime.com](mailto:maqedoni@progresibotime.com)

*Arsyeja  
dhe  
Filorozofia*

NË KËNDVËSHTRIMIN ISLAM

OSMAN NURI TOPBASH



Allahu në Kuran thotë në mënyrë qortuese ndaj atyre që nuk angazhohen dhe përpiqen në kuptimin dhe reflektimin e librit hyjnor: **“Vallë, a nuk reflektojnë ata mbi Kuranin apo i kanë zemrat të kyçura?!”** (Muhamed, 24)

Kurse në një vend tjetër, duke dashur të theksojë natyrën universale të Kuranit, thotë: **“Vërtet, Ne u kemi sjellë njerëzve shembuj në këtë Kuran për çdo gjë, për t’ua vënë veshin.”** (Zumer, 27)

Ndërsa në një ajet tjetër, krahas theksimit të karakterit universal të Kuranit, duke dashur të vërë në dukje edhe natyrën kundërshtuese të njeriut, thotë: **“Sigurisht, në këtë Kuran, Ne u kemi shpjeguar njerëzve çdo lloj shembulli, por njeriu kundërshton më tepër se çdo krijesë tjetër.”** (Kehf, 54)



**Pejgamberi** ﷺ, në një thënie të tij, thotë: *“I mençur është ai që përmban veten dhe punon për jetën mbas vdekjes, kurse mendjelehtë është ai që jepet mbas dëshirave dhe shpreson mëshirën e Allahut pa kurrfarë merite.”* (Tirmidhiu, Kijamet, 25/2459)

Kurse **Abdullah ibn Mesudi**, në këtë kontekst ka thënë:

*“Kush dëshiron dituri le të përqendrohet në leximin, kuptimin dhe interpretimin e Kuranit, sepse në të gjenden të gjitha dituritë.”* (Hejthemi, VII. 165; Bejhaki, Shuab, II, 331)

**Shabiu** thotë:

*“Beto hem tek Allahu se, nëse nuk i nënshtroheni shpalljes hyjnore, por bazoheni vetëm në logjikë, haramin do ta konsideroni hallall, kurse hallallin haram.” (Darmiu, Mukaddime, 22/198)*



**Ibn Sirini** ka thënë:

*“I pari që ka përdorur logjikën, duke anashkalluar shpalljen hyjnore ka qenë Shejtani. Logjika e pambështetur tek shpallja i ka çuar njerëzit drejt adhurimit të diellit, hënës dhe idhujve.” (Darimiu, Mukkadime, 22/196)*



**Rumiu** është shprehur:

*“Vëlla! Përpiqu të gjesh jetë përmes reflektimit... Nëse reflektimi yt është trëndafil (nëse është i mbështetur në Kuran dhe Sunet), ti je në një bahçe trëndafilash, nëse reflektimi yt është gjemb (nëse është i mbështetur mbi dëshirat dhe egon), atëherë ti je duke e zhytur veten në Xhehenem.”*

*“Për sa kohë që shpirti im do të jetë në këtë trup, unë do të jem rob i Kuranit, pluhur i rrugës së Muhamed Mustafasë... Nëse ndonjëri vendos në gojën time ndonjë fjalë që bie në kundërshtim me Kuranin dhe Sunetin, unë jam krejtësisht i distancuar prej tij dhe fjalës së tij...!”*



## PARATHËNIE

Së pari, falënderojmë Allahun, i Cili na krijoi nga hiçi, na bëri krijesën më të shtrenjtë dhe më të çmuar në gjithë universin dhe na dhuroi Islam, imanin, Kuranin dhe mirësi të tjera pa fund.

Bekime dhe nderime pa fund për pejgamberët, të cilët bënë përpjekje madhështore për të shpëtuar njerëzimin nga errësira e mosbesimit dhe paganizmit, duke e udhëhequr atë drejt dritës së imanit. Nderime të veçanta, të singerta dhe të përzemërta për Pejgamberin e fundit, Muhamed Mustafanë ﷺ, i cili përmbushi me sukses vullnetin e Allahut në tokë.

Një nga argumentet e madhështisë dhe plotësisë së Allahut është bukuria dhe përsosmëria e krijimit të njeriut. Për të kuptuar realitetin e kësaj bote dhe arritur lumturinë e amëshuar, Allahu i ka dhënë njeriut një sërë aftësish, si: arsyen, zemrën, ndërgjegjen etj. Këto dhunti janë të nevojshme për të kuptuar realitetin në tërësi, por janë të pamjaftueshme për t'i plotësuar dhe përsosur këto dhunti. Allahu ka dërguar **pejgamberët** dhe **librat hyjnorë**. Allahu me mëshirën e Tij të pafundme, për të mos



privuar asnjë njeri nga kjo begati e ka filluar procesin e dërgimit të peygamberëve qysh me njeriun e parë.

Përmbajtja e urdhëresave dhe ndalesave që kanë lidhje me jetën shoqërore dhe dispozitat praktike, ka qenë e kushtëzuar nga zhvillimi që ka shënuar njerëzimi gjatë shekujve, kurse paralel me këtë, përmbajtja e parimeve të besimit ka qenë gjithmonë e njëjtë dhe statike.

Mbas shumë mesazhesh hyjnore Allahu dërgoi **Kuranin** si vulën e gjithë mesazheve hyjnore dhe si udhërrëfyes për gjithë njerëzimin deri në ditën e Kiametit. Kjo mirësi e mrekullueshme, e cila do të vazhdojë deri në ditën e Kiametit, është manifestim i mëshirës së Allahut ndaj njerëzve.

Allahu ndër gjitha krijesat e Tij ka zgjedhur vetëm xhindët dhe njerëzit si objekt testimi dhe provimi. Testimi në këtë botë vlen për të nxjerrë në pah vepërmirin nga vepërkeqi. Prandaj, njerëzit dhe xhindët janë të prirur nga e mira dhe nga e keqja. Për t'i ndihmuar njerëzit dhe xhindët në arritjet e së vërtetës hyjnore dhe përmbushjen me sukses të adhurimeve, Allahu ka krijuar të gjitha krijesat e tjera në shërbim të tyre.

Pra, qëllimi i krijimit është njohja e Allahut dhe ibadeti ndaj Tij nga ana e xhindëve dhe njerëzve.

Për të përmbushur këtë qëllim, dhuntitë e nje-



rëzve dhe xhindëve janë përforcuar dhe përsosur përmes shpalljeve së herëpashershme hyjnore.

Ashtu si syri që e ka të nevojshme dritën për të shikuar edhe mendja ka nevojë për Kuranin dhe Sunetin, për të arritur të vërtetat hyjnore. Sepse mendja e njeriut vetëm përmes dritës së Kuranit dhe Sunetit mund ta arrijë të vërtetën dhe mirësinë. Nëse nuk do të ishte drita e **Kuranit** dhe **Sunetit**, të cilët zgjerojnë horizontin e mendimit tonë, atëherë një sërë të vërtetash do të mbeteshin të panjohura për ne. Kapja vetëm pas arsyes, duke anashkaluar shpalljen, nuk do mund të na shpëtonte nga labirintet e errëta dhe shkatërruese në të cilat humbën një sërë filozofësh.

Sipas dëshmisë së qartë të historisë, të gjitha teoritë filozofike që i kanë premtuar njeriut lumturinë dhe qetësinë vetëm në planin material, nuk kanë arritur të sigurojnë lumturinë e premtuar as për predikuesit dhe as për ndjekësit e tyre. Sepse fundja, filozofi është një njeri dhe si i tillë e ka të pamundur të njohë ekzistencën në tërësi, më mirë se Krijuesi i saj. Kurse peygamberët, të mbështetur nga shpallja i kanë ofruar njerëzimit recetën e lumturisë në këtë botë dhe në botën tjetër.

Njerëzimi në asnjë periudhë nuk është privuar nga shpallja hyjnore. Sipas një transmetimi, kanë ardhur mbi 124 mijë peygamberë deri sa në fund njerëzimi u nderua me Peygamberin dhe fenë e fundit,



e aftë për të udhëhequr njerëzimin drejt lumturisë së amëshuar dhe përgjigjur njerëzimit për të gjitha situatat dhe çështjet deri në ditën e Kiametit. Pejgamberi ﷺ, pas një periudhe 23- vjeçare predikimi të fesë islame, përmbushi me përpikmëri mirësinë më të madhe të Allahut mbi njerëzit. Pas kësaj, e vetmja fe e pranuar tek Allahu është Islami dhe çdo zgjedhje tjetër përveç Islamit është e refuzuar.<sup>1</sup>

Islami ka botëkuptimin më të përkryer. Që një sistem të konsiderohet një botëkuptim i përkryer, duhet t'i japë përgjigje çdo pyetjeje që mund të vijë nga mendja njerëzore. Përveç kësaj, përgjigjet përkatëse duhet të përbëjnë në vetvete një të tërë jokondradiktore, por logjike, sistematike dhe harmonike. Këto cilësi gjenden vetëm në **Botëkuptimin Islam**.

Feja islame ofron një botëkuptim dhe sistem rregullash e sjelljesh gjithëpërfshirëse. Islami ka rregulluar në mënyrën më të përsosur të gjitha fushat e jetës, duke filluar nga marrëdhëniet ndërnjerëzore, marrëdhëniet e njeriut me mjedisin dhe më e rëndësishmja, marrëdhënien e njeriut me Krijuesin e gjithësisë. Nga kjo pikëpamje, njeriut i mjafton të zbatojë këtë manual udhëzues.

Të gjitha botëkuptimet e feve të tjera, qofshin këto fe hyjnore të deformuara apo të sajua nga



vetë njerëzit, por veçanërisht botëkuptimet që kanë sjellë filozofët, janë plot mangësi dhe kundërthënie.

Të nderuar lexues!

Sot jetojmë në një botë ku kultura globale e ka burgosur mendimin e njeriut brenda mureve të materializmit dhe kapitalizmi i egër ka sjellë sëmundjen e ambicieve të njeriut. Me dhimbje jemi dëshmitarë të përpjekjes së teorive dhe sistemeve njerëzore për të përjashtuar fenë dhe jetën shpirtërore nga çdo fushë e jetës.

Si reaksion i përmbajtjeve plot kundërthënie të hebraizmit, për shkak të ndërhyrjeve njerëzore dhe të krishterimit, doktrina e të cilit u vendos nga koncilë<sup>2</sup> të ndryshëm që u mbajtën mbas Isait عليه السلام, lindi në perëndim rryma racionaliste, e cila kundër-

2. Për të treguar se si është deformuar një fe hyjnore, t'i hedhim një sy vendimeve që janë marrë nga konsilet:

Në këshillin e Nikesë të vitit 325 u vendos natyra hyjnore e Isait عليه السلام, kurse në Këshillin e Stambollit u vendos për hyjnitëtin e shpirtit të shenjtë.

Në këshillin e Efesit të vitit 431 Merjemja u shpall "Theotokos" "nëna e zotit". Në këshillin e Kaldedonit të vitit 451 kisha e lindjes, e cila mbronte natyrën monofizite të Isait u shpall e devijuar nga rryma e cila mbronte natyrën diofizite të Isait عليه السلام.

Në këshillin e dytë të Nikesë u vendos për lejimin e adhurimit të ikonave, deri atëherë ishin përjetuar debate të forta për lejimin apo jo të adhurimit të ikonave, madje disa imperatorë e kishin ndaluar adhurimin e ikonave.

Ndërsa ortodoksët pranojnë vetëm shtatë koncilët e parë, katolikët me gjithë koncilin e fundit të mbajtur në vitin 1965, pranojnë 21 koncile. Në koncilin e fundit kisha katolike bëri thirrje për dialog midis sekteve dhe feve të tjera



shtonte mësimet e fesë, duke i dhënë përparësi vetëm arsyes.

Është krejtësisht normale që mendimtarët perëndimorë, të cilët nuk i gjetën përgjigjet në fetë e tyre të vihen në kërkim të rrugëve të tjera. Mirëpo paragjykimi, keqinformimi dhe fanatizmi shekullor i perëndimit ndaj fesë islame i pengon ata për t'u drejtuar nga Islami. Në fakt, ajo që ata përpiqen të gjejnë është në fenë islame, por janë paragjykimet që nuk lejojnë shikimin e realitetit. Ky është shkaku që numri i personave që janë nderuar me Islam në perëndim ka qenë i vogël. Megjithëse me zhvillimin e teknologjisë së informacionit vihet re një rritje e dukshme e numrit të personave të konvertuar në Islam, përsëri është i papërfillshëm në krahasim me numrin e popullsisë në përgjithësi. Prandaj nuk është për t'u habitur nga vlera dhe rëndësia e madhe që ka filozofia në syrin e njeriut perëndimor.

Arritja e një niveli të lartë zhvillimi shkencor, teknik dhe teknologjik vetëm në saje të respektimit të metodave racionaliste dhe empiriste nga ana e perëndimit, ka krijuar dhe përhapur idenë e gabuar midis popujve myslimanë se zhvillimi është i mundur vetëm përmes filozofisë racionaliste, e cila predikon hyjnizimin e arsyes duke mënjanuar fenë. Armiqtë dhe dashakeqësit e Islamit, duke injoruar faktin që myslimanët për sa kohë që i qëndruan besnikë fesë së tyre, krijuan qytetërimin më madhështor që ka



njohur njerëzimi, po bëjnë përpjekje serioze për të injektuar në mendjet e myslimanëve idenë se zhvillimi dhe progresi është i mundur vetëm përmes racionalitetit dhe empirizmit. Fatkeqësisht, këto ide në botën islame janë përhapur si një virus i rrezikshëm epidemik.

Përballë këtij rreziku myslimanët dhe sidomos ata që studiojnë shkencat islame, duhet të tregohen shumë vigjilentë dhe të kujdesshëm.

Shkaku kryesor i molepsjes mbas filozofisë perëndimore është mosnjohja sa duhet e madhësishtisë së qytetërimit dhe botëkuptimit islam. Kjo i ngjan personit që nuk e di çfarë është dielli dhe mahnitet mbas dritës së qiriut.

Duke u nisur nga kjo gjendje, e pamë të domosdoshme që disa të vërteta t'ia ofrojmë lexuesit në mënyrë të përmbledhur në këtë libërth modest.

Si literaturë për përgatitjen e këtij libri kemi përdorur, “*Botëkuptimi islam*” i **Kadir Mësëroglu**, “*Mendimi perëndimor dhe mistika islame*”, i **Nexhip Fazëll**, “*el-Munkidhmin ed-Dalale*”, i **Imam Gazalit**, *Mektubat*, të **Imam Rabanit** dhe disa vepra të **Bediuzzaman**.

**Lusim Allahun të mos na privojë nga ushqimi shpirtëror i Kuranit. Lusim Allahun të na mbajë në gjurmët e pejgamberëve, dijetarëve dhe njerëzve të urtë, të cilët janë trashëgimtarë të**



**pejgamberëve. Lusim Allahun të na japë zgjuarsi për të kuptuar, mësuar dhe zbatuar Kuranin në të gjitha fushat e jetës, sepse e vetmja mënyrë për të arritur tek Allahu është rruga të cilën Ai e ka treguar në librin e Tij fisnik.**

**Amin!..**

**Osman Nuri Topbash**

Shkurt, 2013

Yskydar





## Filozofia dhe arsyeja në këndvështrimin ISLAM

Mendjen e njerëzimit e kanë preokupuar dhe preokupojnë, në menyrë të vazhdueshme, pyetje të tilla si: Çfarë roli dhe vendi ka filozofia në Islam? Deri ku mund të arrijë mendja, të cilën filozofia e konsideron si mjetin më të rëndësishëm për të arritur të vërtetën? A e ka fuqinë e mjaftueshme mendja për të peshuar të gjitha të vërtetat? Çfarë rruge duhet ndjekur mbas kufirit ku arsyeja është e pafuqishme për të dhënë gjykim?

Së pari, duhet të theksojmë që filozofia mbështetet plotësisht mbi arsye kurse Islami mbështetet edhe mbi arsye edhe mbi shpallje.

Edhe pse midis sistemit të mendimit islam, i cili mbështetet mbi të vërtetat hyjnore dhe sistemit filozofik të mbështetur në fuqinë e kufizuar të arsyes dhe të pambrojtur nga gabimi njerëzor mund të ketë ngjashmëri, ato kanë dallime parimore dhe esenciale për nga metoda dhe mjetet që përdorin.

Pavarësisht nga kjo, në botën islame, me emërtimin e përhapur “**filozofia islame**” bëhet fjalë për pikëpamjet e filozofëve të përgatitur brenda mendi-



mit dhe meditimit islam ose pikëpamjet e atyre që në sistemin e tyre meditativ i kanë dhënë përparësi dhe peshë filozofisë. Prandaj, nuk duhet nënkuptuar se Islami është i përputhshëm me filozofinë. Për shembull, edhe Islami është në një farë mase racionalist. Islami i jep rëndësi të madhe mendjes, duke e konsideruar atë si një nga dy kushtet për të qenë përgjegjës. Kushti i parë është pjekuria seksuale, kurse tjetri është mendja e shëndoshë, e cila arrin të dallojë të mirën nga e keqja, të lejuarën nga e ndaluara. Prandaj në Islam, fëmijët dhe njerëzit me të meta mendore nuk janë përgjegjës për veprimet që kryejnë.

Islami, i cili i jep kaq rëndësi arsyes, i nxit besimtarët që në çdo rast të reflektojnë mbi të vërtetat e jetës, universit dhe urtësitë e shenjave hyjnore. Dhe kjo mund të arrihet vetëm përmes arsyes së pastër dhe të mbrojtur nga kushtëzimet negative.

Megjithatë, sipas Islamit, arsyeja është e kufizuar në perceptimin e realitetit, sepse Allahu asnjë krijese nuk i ka dhënë fuqi të pakufishme.

Të gjitha krijesat janë të kufizuara në aftësitë që zotërojnë, nuk ka asnjë krijesë me fuqi të pakufizuar. Prandaj dhe arsyeja, duke qenë e kufizuar, gjatë rrugës së saj të kërkimit të së vërtetës, mund t'i ofrojë njeriut një mundësi të kufizuar. Të vërtetat që përmban jeta dhe universi janë të pafundme dhe shumë prej tyre të pakapshme për mendjen e



njeriut. Kjo e vërtetë, nga njëra anë tregon domosdoshmërinë e arsyes për të njohur realitetin, kurse nga ana tjetër tregon pamjaftueshmërinë e saj për ta njohur atë si duhet. Dijetarët islamë e kanë konsideruar arsyen si të paaftë për të gjetur e vetme të vërtetën në tërësi.

Kjo është arsyeja që imani përkufizohet si shprehje me gojë dhe besim me zemër. Ky parim madje, tregon se qëllimi i dëshiruar nuk mund të arrihet vetëm përmes arsyes. Në momentin që arsyeja dorëzohet, është e domosdoshme veprimtaria e zemrës. Vetëm nëpërmjet saj mund të arrihet qëllimi.

Sado e zhvilluar të jetë mendja njerëzore, të vërtetat që mund të arrihen përmes saj janë një **“Hiç”** përballë të vërtetave që informon Krijuesi ynë.

Siç e konfirmon edhe ajeti kuranor:

**“Ai përfshin çdo gjë me dijeninë e Vet.”**

(Araf, 89)

Kurse dituria njerëzore nuk është në gjendje të njohë as çfarë mund të ndodhë të nesërmen. Arsyeja asnjëherë nuk mund të arrijë ta rrokë të vërtetën në të gjitha aspektet e saj pa ndihmën e shpalljes hynore.

Pra, nëse arsyeja udhëhiqet nga shpallja hyjnore, ajo e ka përmbushur me sukses qëllimin për të cilin Allahu e ka krijuar.



## Një pikë nga oqeani...

Mendimet dhe ndjenjat që përjeton artisti gjatë krijimit të një vepre artistike nuk mund t'i dijë askush më mirë se sa vetë artisti. Po kështu, është i pamundur zbulimi i të gjitha urtësive në gjithësi përmes mendjes njerëzore, e cila vetë është krijesë dhe, duke qenë e tillë, fuqia e saj është e kufizuar. Kjo vjen për faktin e thjeshtë se dituria e krijuesit nuk mund të jetë kurrë e barabartë me diturinë e krijesës. Dituria e njeriut në krahasim me diturinë e Krijuesit, është si një pikë ujë në oqeanin e pafund.

Prandaj mendja e njeriut nuk mund ta njohë siç duhet Krijuesin e gjithësisë, sepse burimet e njohjes së njeriut janë: shqisat, arsyeja dhe intuita, fuqia dhe aftësia e të cilave është e kufizuar. Për rrjedhojë, është e pamundur që përmes mjeteve të kufizuara të njihet siç duhet Krijuesi i gjithësisë, i cili është i pafillimtë, i pafund, i përhershëm dhe absolut. Njohja përmes mjeteve të kufizuar është një njohje e kufizuar. Pra, nga oqeani mund të marrim aq ujë sa nxë ena.

Ky hadith i Pejgamberit ﷺ, e shpreh shumë bukur këtë të vërtetë:



Gjatë udhëtimit në det të Musait عليه السلام me Hizrin, për të mësuar urtësitë e fshehta, në direkun e anijes ndaloi një harabel, pastaj me sqepin e tij të vogël filloi të merrte ujë. Hizri, duke parë veprimin e zogut, iu drejtua Musait عليه السلام, duke i thënë:

“Dituria ime, e jotja dhe e gjithë njerëzimit, në krahasim me diturinë e Allahut, është sa sasia e ujit që mund të marrë harabeli me sqepin e tij prej detit.” (Buhari, tefsir, 18/2-4)



## Mistere hyjnore që ngjallin admirim

Ngaqë arsyeja është e paaftë për të njohur dhe kuptuar shumë të vërteta hyjnore, Islami urdhëron për besim në botën e përtejme dhe të padukshme.

Ndër argumentet më të forta, që tregojnë paaf-tësinë e arsyes për të njohur një sërë të vërtetash hyjnore, janë diskutimet dhe debatet historike në lidhje me natyrën e shpirtit. Siç dihet, filozofët dhe shkencëtarët për shekuj me radhë janë përpjekur të zbulojnë natyrën e vërtetë të shpirtit. Dhe pas shumë përpjekjeve pa rezultat, u detyruan të pranojnë pamundësinë e njohjes së natyrës së shpirtit, duke u mjaftuar vetëm me njohjen e ekzistencës së tij.

Pas diskutimeve dhe kërkimeve shekullore mbi shpirtin, lindi shkenca e shpirtit ose psikologjia. Objekti i studimit të psikologjisë nuk është më natyra e shpirtit; ajo, duke e pranuar apriori ekzistencën e shpirtit studion sjelljet që lindin prej tij.

Kjo tregon se edhe filozofët kanë mbetur të detyruar të pranojnë natyrën e kufizuar të arsyes për të njohur realitetin. Sot asnjë filozof nuk interesohet më për natyrën e shpirtit, kurse psikologët thjesht



studiojnë sjelljet që burojnë prej tij. Pamundësinë e njohjes së natyrës së shpirtit dhe diturinë e paktë të njeriut në lidhje me shpirtin, Kurani e ka deklaruar shekuj më parë.

Pra, Kurani gjithmonë u paraprin shkencave, kurse shkencat njerëzore thjesht janë të detyruara ta ndjekin atë.

Ky është shembull tipik i dështimit të të gjitha kërkimeve shkencore, të cilat janë përpjekur të sfidojnë të dhënat dhe të vërtetat kuranore. E vetmja rrugëzgjdhje e shkencës është dorëzimi i plotë tek shpallja kuranore.

Po ashtu, njohuria rreth qenies së Zotit është e pamundur dhe jashtë çdo fuqie të mendjes. Çdo përpjekje për të arritur një përfundim në këtë çështje është e kotë.

Prandaj Pejgamberi ﷺ, në lidhje me këtë çështje, i ka këshilluar besimtarët:

*“Meditoni mbi krijesat dhe mirësitë e Allahut, por mos meditoni mbi qenien e Allahut, sepse ju në asnjë mënyrë nuk mund ta imagjinoni Atë.”*

(Bejhaki, Shuab, I, 136)

Ashtu si shpirti edhe Qenia e Allahut është e pakapshme për mendjen njerëzore, prandaj nuk na mbetet gjë tjetër përveçse ta pranojmë në mënyrë apriori ekzistencën e Tij.

Islami për çështje të tilla të pakapshme për



mendjen ka ndaluar diskutimin dhe debatin, duke iu dorëzuar plotësisht gjykimeve hyjnore. Vetë fjala “Islam” vjen prej rrënjës trishkronjëshe “s-l-m”, e cila, krahas kuptimit paqe ka edhe kuptimin e nënshtrimit.

Musai عليه السلام, mbeti i habitur kur u përball me një sërë veprimesh të Hizrit, tek i cili kishte shkuar për të fituar dituri. Në peshoren e racionalitetit, veprimet e Hizrit i dukeshin krejtësisht absurde dhe përballë pamundësisë për t’i dhënë një shpjegim logjik, ai e kundërshtoi atë.

Hizri e kishte paralajmëruar qysh në fillim Musain عليه السلام, se nuk do mund të duronte në rruqën e kërkimit të kësaj diturie, e cila ishte përtej arsyes njerëzore. Me këtë kishte dashur t’i tregonte se shpjegimi logjik i kësaj diturie ishte i pamundur nga arsyeja, prandaj kërkohet dorëzim total.

Më në fund, kur Hizri i tregoi urtësitë e veprimeve të tij, Musai عليه السلام, e kuptoi që ekzistonin një sërë të vërtetash të tjera të pakapshme për arsyen e njeriut.

Në lidhje me këtë ngjarje, në koleksionin e Buhariut gjendet një hadith i tillë:

*“Allahu e mëshiroftë Musain, birin e Imranit. Sikur të tregonte durim, Hizri do t’i mësonte atij shumë gjëra interesante.”* (Buhari, Enbija, 27; Ahmed ibn





Ky është shkaku që në Islam ekziston bindja dhe dorëzimi për një sërë të vërtetash dhe faktesh, të cilat janë të pakapshme për mendjen e njeriut. Prandaj, në rrugën drejt kërkimit të së vërtetës, mendja e shëndoshë ia arrin qëllimit vetëm kur udhëhiqet dhe i dorëzohet shpalljes hyjnore.

Në fakt, racionalizmi i Islamit është i ndryshëm nga pikëpamja e racionalistëve, të cilët pothuajse e adhurojnë arsyen, të cilët e pranojnë si të pakufizuar forcën e arsyes. Islami është një sistem realist, i cili e vlerëson arsyen brenda kufijve të saj.



## Peshore e saktë...

Ashtu si aftësia e shikimit dhe dëgjimit është e kufizuar edhe aftësia e mendjes për të kuptuar është e kufizuar. Përtej kufirit të shikimit mund të ketë jetë dhe botë pa fund. Po ashtu, ekzistojnë shumë zëra, të cilët veshi i njeriut nuk arrin t'i dëgjojë, për shkak se janë jashtë frekuencave të dëgjimit. Si këto ekzistojnë shumë të vërteta, të cilat janë të paperceptueshme nga mendja. Mendja është e paaftë për t'i kuptuar këto të vërteta.

Dijetari i famshëm, sociologu dhe babai i filozofisë së historisë, Ibn Halduni, në lidhje me aftësitë e arsyes thotë:

*“Arsyeja është një peshore e saktë, por Zoti, bota e përtejme, shpallja hyjnore dhe shumë çështje të tjera metafizike nuk mund të maten dhe peshohen përmes arsyes. Çdo përpjekje për të peshuar çështjet metafizike përmes arsyes, është e destinuar të dështojë. Peshimi i çështjeve metafizike përmes arsyes i ngjan peshimit të një mali në një peshore analitike. **Saktësia e peshores është e padiskutueshme, por fuqia e saj për të peshuar është e kufizuar, ajo nuk mund të***



*peshojë përtej kufijve të përcaktuar. E njëjta gjë ndodh edhe me arsyen. Edhe ajo ka një limit, përtej të cilit nuk mund të hedhë asnjë hap.”<sup>3</sup>*

Pra, fuqia e arsyes për të kuptuar është e limituar. Nëse një mjeti të programuar për të punuar me 220 volt energji i jepet 2500 volt, sado cilësor të jetë, ai nuk mund ta përballojë atë intensitet energjie. Kjo është një nga arsyet që shumë filozofë, që kanë besuar në fuqinë e pakufishme të arsyes e kanë kaluar jetën ose nëpër spitale psikiatrike, ose kanë kryer vetëvrasje.



---

3. Ibn Haldun, Mukaddime, fq, 473.



## Kërkimi i lumturisë në vende të gabuara

Filozofët, të cilët kanë premtuar lumturinë pavarësisht udhëzimit hyjnor, gjithmonë i kanë zvarritur ndjekësit e tyre në vend të lumturisë dhe shpëtimit, në mjerim dhe humbje.

Filibeli Hilmi Efendiu, në veprën e tij “*Ahmak-i Hayal*”, në mënyrë figurative tregon si ta shndërroj-më mjerimin në gëzim.

Heroi i tregimit, Raxhiu i trazuar shpirtërisht, vihet në kërkim të lumturisë. Rugës takon një njeri të urtë duke i rënë nejit dhe duke recituar poezi melodike. Raxhiu, i ndikuar nga atmosfera, zhytet thellë në botën imagjinare dhe e gjen veten në një mexhlis, në të cilin merrnin pjesë pejgamberë, filozofë, intelektualë dhe njerëz të thjeshtë. Një person, i cili përfaqësonte gjithë njerëzimin në rrugën e kërkimit të lumturisë, iu drejtua të pranishmëve me një zë vajtues:

- Më tregoni ju lutem; më është mërzhitur jeta, por edhe pa të nuk bëj dot. Ju lutem, më përkufizoni lumturinë e vërtetë.

Nga të pranishmit u ngritën disa personalitete,



ku secili bëri përkufizimin e vet.

Platoni: “Lumturia është të mendosh gjithmonë sublimen.”

Aristoteli: “Logjika është lumturia e vërtetë.”


Zerdushti: “Lumturia është shpëtim nga errësira.”

Brahama: “Lumturia është e kundërta e asaj që mendoni.”


Buda: “Lumturia është nirvana, tretja në botën transhendentale.”

Përballë këtyre përkufizimeve të shumta, përfaqësuesi i njerëzimit, i turbulluar dhe i pështjelluar tha:

- Ju nuk jeni të dobishëm për veten tuaj, jetën tuaj e kaluat të gjithën të privuar nga lumturia. Edhe ato që thatë nuk kanë lidhje aspak me lumturinë. As vetë nuk ishit të lumtur dhe as ndjekësit tuaj nuk i bëtë të lumtur. Mendimet tuaja kanë ngelur në librat e pluhurosur nëpër raftet.

Pastaj çohen peygamberët dhe shpjegojnë çfarë është lumturia. Në fund ngrihet vula e peygamberëve, Muhamedi  dhe u drejtohet njerëzve:

*“O njerëz! Lumturia është të pranosh jetën siç është, të durosh vështirësitë dhe të përpiqesh të përmirësosh jetën në tokë.”*

Njerëzimi, i kënaqur nga përgjigjja, ngrihet në këmbë dhe i thotë Peygamberit :

*“O Krenaria e gjithë njerëzimit! Vetëm Ti i*



*kupton shqetësimet e njerëzimit dhe vetëm Ti mund të gjesh ilaçin për shërimin e tyre.*"<sup>4</sup>

Njeriu duhet t'i dorëzohet plotësisht vullnetit dhe paracaktimit absolut të Allahut, pa u përpjekur ta ndryshojë atë. Njeriu mund të bëjë përpjekje për përmirësimin e gjendjes së vet dhe asaj të njerëzve brenda fushës së vullnetit të lirë të tij, i cili përbën caktimin relativ. Kjo është fusha ku njeriut i është njohur e drejta për të vepruar.

Kjo tregon karakterin realist të botëkuptimit islam. Sepse çdo përpjekje për të ndryshuar atë që e ka vendosur shpallja hyjnore, jo vetëm që nuk është e mundur, por gjithmonë e ka zvarritur njerëzimin drejt mjerimit dhe shqetësimeve.



## Sekreti i qetësisë është përpjekja dhe mbështetja tek Allahu

Jeta e kësaj bote, ngaqë është e bazuar mbi urtësinë e sprovës hyjnore, nganjëherë është arenë e manifestimeve të ashpërsisë, nganjëherë arenë e manifestimeve të butësisë.

Të gjitha dukuritë në Univers sendërtohen dhe bëhen ekzistente me anë të sintezës së shfaqjeve të attributeve hyjnore, të cilat janë dy kategorish: “të ashpra” (xhelâlî) dhe “të buta” (xhemâlî). Kjo nënkuptohet kur thuhet se **“edhe e mira, edhe e keqja janë prej Allahut.”** E rëndësishme është përfitimi prej këtyre dy manifestimeve, duke shprehur kënaqësinë me caktimin e Allahut. Besimtari e manifeston miratimin e caktimit të Allahut përmes falënderimit dhe modestisë përballë mirësisë, dhe durimit e qëndresës përballë fatkeqësisë. I Dërguari i Allahut ﷺ, këtë të vërtetë e shpreh kështu:

*“Është për t’u admiruar gjendja e besimtarit, sepse çdo gjendje e tij është shkak mirësie dhe fitimi. Ai falënderon Allahun për mirësitë ndaj tij, gjë e cila i sjell dobi dhe duron përballë fatkeqësisë, gjë e cila përsëri i sjell dobi atij. Kjo mundësi*



*është vetëm për besimtarin.*” (Muslim, Zuhd, 64)

Kushti i parë i lumturisë dhe qetësisë njerëzore është pranimi me kënaqësi i caktimit hyjnor, kurse kushti i dytë është përpjekja për të rregulluar gjendjen në tokë, pavarësisht vështirësive të mëdha që mund të hasen gjatë kësaj rruge.

Kjo tregon që një pjesë e akteve tona kanë lidhje me kaderin relativ, kjo në të njëjtën kohë tregon që njeriu **zotëron vullnetin** e pjesshëm, i cili e bën edhe përgjegjës atë për veprimet që kryen. Mendimi se gjendja e keqe nuk mund të rregullohet e shpie njeriun në pesimizëm dhe dembelizëm. Mosvënia në lëvizje e vullnetit shkakton dembelizëm.

Strehimi pa ndërmarrë asnjë veprim te caktimi hyjnor, është një shtrembërim i kuptimit të kaderit. Në fakt, koncepti i **fatalizmit** në filozofinë perëndimore nuk është gjë tjetër vetëm kaderi i keqkuptuar.

Në Islam ekziston kaderi **relativ**, i cili formohet sipas manifestimeve të vullnetit të njeriut. Pra, shumë akte dhe veprime janë të varura nga vullneti i lirë i njeriut. Shprehja **“edhe e mira, edhe e keqja janë prej Allahut”** nuk nënkupton pamundësinë e ndryshimit të gjërave. Ajo shpreh pamundësinë e ndodhjes së aktit dhe veprimit pa vullnetin dhe diturinë e Allahut.

Kurse aktet dhe veprimet që ndodhin jashtë





vullnetit të njeriut bëjnë pjesë në **kaderin absolut**, ku qeniet janë si robotë, për sa i përket ekzistencës dhe veprimtarisë së tyre. Lindja, vdekja, kombësia, jetëgjatësia janë jashtë vullnetit dhe zgjedhjes së njeriut. Këto në asnjë mënyrë nuk mund të ndryshohen. Kjo është arsyeja që individi nuk është përgjegjës për pjesën që përfshihet në kaderin absolut.

Allahu u ka njohur të drejtën njerëzve dhe xhindëve; lirshmërinë për të vepruar brenda një fushe të caktuar. Realizimi i aktit sipas vullnetit të njeriut përbën të ashtuquajturin “**kader relativ**”. Nga që ekziston një fushë e tillë veprimi Pejgamberi ﷺ, ka urdhëruar ndryshimin e gjendjes negative, përmirësimin e jetës dhe shfarosjen e padrejtësive.

Le të mendojmë se babai e çon djalin në një njësi shitjeje lodrash për fëmijë, me qëllim që t’i blejë një lodër për t’u zbavitur. Babai, i cili pa dyshim e do dhe e mëshiron të birin, para se i biri të bëjë një zgjedhje, kërkon t’ia përshkruajë atij anët e mira dhe anët e këqija të të gjitha lodrave që ndodhen në atë njësi shitjeje. Ai ia përshkruan djalit me aq sa është e nevojshme veçoritë e çdo lodre: “Kjo është një lodër krejt e parrezikshme, me të cilën mund të luash e të zbavitësh, me këtë tjetrën mund t’ia nxjerrësh syrin shokut, kurse me këtë tjetrën mund t’ia presësh dorën!” Pastaj ia njuh të drejtën të zgjedhë brenda kufijve të asaj njësie shitjeje. Ndërkaq, nëse djali, pavarësisht nga të gjitha orientimet dhe paralajmë-



rimet e babait, zgjedh një lodër të rrezikshme, babai ose paguan dhe ia blen lodrën, domethënë e mbështet realizimin e qëllimit tek i cili drejtohet vullneti i djalit, ose bën të kundërtën, nuk e paguan lodrën, duke e lënë të pafuqishëm vullnetin e djalit.

Ja pra, përballë Zotit me vullnet të përgjithshëm, të gjitha krijesat dhe, në këtë mes, posaçërisht njeriu, i përngajnë fëmijës tek shembulli i mësipërm. Po të vihet re me kujdes, jo vetëm vullneti i tij vetjak është i pamjaftueshëm për ta realizuar qëllimin, por edhe fusha ku mund të realizohet ai vullnet është e kufizuar.

Të gjitha këto tregojnë krijimin e njeriut dhe xhindëve për t'u sprovuar në këtë botë. Prandaj, njeriu duhet që vullnetin e tij të lirë ta përdorë në përputhje të plotë me vullnetin hyjnor dhe vazhdimisht të jetë në përpjekje për të fituar dashurinë hyjnore. Sepse, siç këshillon ajeti kuranor:

***“Ju mund të urreni një gjë, ndërkohë që ajo është e mirë për ju e mund ta doni një gjë, ndërkohë që ajo është e dëmshme për ju. Allahu di, kurse ju nuk dini.”*** (Bekare, 216) ne nuk jemi në gjendje përmes arsyes të kuptojmë të gjitha urtësitë. Rruga e shpëtimit është dorëzimi tek shpallja hyjnore.



## Arsyeja e milingonave

Filibeli Ahmet Hilmi, për të treguar kufizueshmërinë e arsyes njerëzore, në veprën e tij “*A’mâk-ı Hayal*” (*Thellësitë e Imagjinatës*), jep shembull tregimin e Raxhiut. Raxhiu shkon pas një kohe për vizitë tek “**Babai i pasqyrës**”.

Babai i bën një kafe. Ndërsa Raxhiu pinte kafën, babai i binte fyellit. Raxhiu, ndërsa po dëgjonte fyellin, zhytet thellë përsëri në botën e imagjinatave.

Në botën e ëndrrave e gjen veten të shndërruar në milingonë mes milingonash të tjera, në një fole milingonash me një mijë labirinte. Raxhiu fillon të shqyrtojë mjedisin përreth, duke parë me sy të habitur. Edhe milingonat ishin ndarë në grupe, ashtu siç ndahen njerëzit në klasa shoqërore të ndryshme. Vetëm se grupimet e tyre nuk u ngjanin aspak klasave shoqërore të njerëzve. Më e çuditshmja ishte se kishin një gjuhë të përkryer, të aftë për të shprehur çdo lloj nevojë materiale e shpirtërore. Në fole kishte shkolla të mrekullueshme, depo ushqimesh, fjetore, burgje, sallone ngrënieje dhe pushimi, vende mbledhjeje, shkurt, ekzistonte tërë shkëlqimi i një qyteti, i një shtëpie të domos-



doshme për jetën shoqërore. Raxhiu i shndërruar në milingonë ishte biri i një princi milingonash. Për arsimimin dhe edukimin tij, princi kishte zgjedhur mësuesit më të mirë. Brenda një kohe të shkurtër arritën t'i mësonin Raxhiut të gjitha dituritë. Dijetari milingonë i lëndës së gjeografisë e nxjerr Raxhiun së bashku me një grup të madh nxënësish në terren për t'u treguar teorinë në praktikë. Ndërsa profesori i gjeografisë tregonte për malet, kodrat, liqenet, pyjet etj., papritmas, mes dëgjuesve, numri i të cilëve i kalonte qindra mijërat, shpërtheu një klithmë e tmerrshme. Megjithëse qielli ishte i hapur dhe pa re, shpërtheu një rrebesh që nuk mund të krahasohej me rënien e shiut më të rrëmbyeshëm, si dhe një stuhi e nxehtë nisi t'i merrte me vete e t'i mbyste brenda një çasti mijëra milingona! Lumi apo më mirë të themi lumenjtë, që u formuan nga rrebeshi i lëshuar prej lart, merrte me vete e shkatërronte grumbuj të tërë prej mijëra milingonash! Çdokush ikte me vrap në një anë, pa parë se nga shkonte! Kurse Raxhiu pas frikës dhe panikut të çastit, u rrëmbye nga dëshira për të kuptuar shkakun e atij rrebeshi dhe stuhie. Raxhiu, i cili zotëronte arsyen e njeriut dhe të milingonës vuri re se ajo që milingonat e pandehnin rrebesh, ishte urina e dy kuajve aty pranë.



një ditë me diell pa asnjë re. Të gjithë hidhnin nga një mendim logjik dhe shkencor sipas milingonave, por që në të vërtetë nuk kishte aspak lidhje me të vërtetën.

Kur dëgjoi këtë shpjegim, Raxhiut iu shfaqën para syve kuajt e lodhur që lëshonin urinën, por duke qenë i vetëdijshëm se nuk do ta besonte kush po t'u tregonte të vërtetën, dëgjoi në heshtje dhe me durim shpjegimet e shkencëtarëve dhe dijetarëve milingona dhe, pasi lëshoi një të qeshur të madhe, u zgjua. Kurse babai i pasqyrës recitonte poezinë:

*Dielli digjet, toka n'rrotullim.  
Vjen një ditë, të gjitha shuhen.  
O i ditur! Pse ndodhë kështu,  
Ke ndonjë mendim?<sup>5</sup>*

Sic e ilustroi shumë bukur ky tregim, arsyeja njerëzore nuk ka ndonjë dallim nga milingonat, për sa i përket aftësisë së saj për të kuptuar të gjitha të vërtetat në tërësi dhe thelb. Perceptimi i mrekullive hyjnore në univers nga një arsye e privuar nga drita e zbulesës hyjnore, nuk ka dallim nga perceptimi i milingonave në tregim.

Të mos lëmë pa përmendur që një nga shfaqjet e mëshirës dhe mirësisë së Allahut ndaj njerëzve janë ëndrrat, sepse ëndrrat janë një udhërrëfyes për të

---

5. A'makul'Hayal, fq. 113-117.



arritur tek të vërteta metafizike të jetës. Në botën e ëndrrave ndodhin një sërë ngjarjesh, të cilat janë të pamundura në jetë. Kjo na krijon mundësinë e kuptimit më lehtë të mësimëve islame në lidhje me botën e përtejme.

Ata që pretendojnë shpëtimin e njerëzimit përmes arsyes, pa ndjekur rrugën e pejgamberëve dhe ndjekësve të tyre, do të mbeten gjithmonë në gjendjen e milingonave në tregimin e mësipërm.

Pejgamberët, ngaqë kanë qenë të mbështetur nga shpallja hyjnore, kanë miratuar njëri-tjetrin, kurse filozofët, të cilët kanë qenë larg shpalljes hyjnore dhe të mbështetur vetëm në arsye, gjithmonë kanë kundërshtuar dhe mohuar njëri-tjetrin.

Paskali, i cili kaloi një jetë të tërë në vorbullën e filozofisë dhe pasi kuptoi pamjaftueshmërinë e arsyes, i drejtuar nga misticizmi, thotë:

*“Filozofia dhe teoritë e saj gjithmonë janë subjektive. Për shembull, ajo që në njërin anë të maleve Pirene konsiderohet e saktë, në anën tjetër konsiderohet gabim. Në njërin anë të lumit vrasësi konsiderohet kriminel, kurse në anën tjetër hero.”*



## Për çfarë shërben arsyeja, pasi të ikën anija?

Duhet të theksojmë që jo të gjitha teoritë dhe mendimet filozofike janë të gabuara, sepse filozofët pas përpjekjeve intelektuale kanë arritur disa të vërteta.

Filozofi dhe matematikani, i cili konsiderohet babai i racionalizmit dhe filozofisë moderne, **Dekarti**, duke u nisur nga argumenti ontologjik, ka arritur në përfundimin se burimi kryesor i së vërtetës është shpallja hyjnore. Në veprën e tij “Mendime mbi metafizikën” thotë:

*“Zoti është një qenie e përsosur, pa të meta dhe e pagabueshme. Prandaj edhe dituria e Tij është e vërtetë dhe pa të meta. Ngaqë Zoti është i përsosur, nuk gabon. Përderisa nuk gabon, çdo dituri e Tij është e saktë. Nëse thotë që universin e kam krijuar unë, është e vërtetë që e ka krijuar Ai. Prandaj, burimi i diturisë së saktë është dituria e Zotit.”*

Kurse **Paskali**, në mbështetje të këtij mendimi, thotë:

*“Është një zë që na vjen nga thellësitë e ekzis-*



*tencës sonë dhe që na e bën të ditur që jemi të pavdekshëm: është zëri orientues i Zotit që na ngushëllon...”*

Mirëpo, filozofë të tillë, si: Dekarti, Spinoza, Paskali, Kanti dhe të tjerë, të cilët pas arsytimeve logjike arritën në përfundimin se pranimi i ekzistencës së Zotit është një domosdoshmëri, duke mos e njohur fenë islame mjaftueshëm, për shkak të ndikimit të krishterë dhe kushtëzimit negativ ndaj Islamit, nuk arritën t’i plotësonin mendimet e tyre. Prandaj nuk kemi asnjë dëshmi, që filozofë të tillë të kenë pranuar besimin e pastër të Tevhidit, i cili është kushti i parë dhe kryesor i lumturisë në të dyja botët. Poeti dhe shkrimtari **Nexhip Fazël** e ngjason gjendjen e tyre me ata të cilët janë afruar në skelën e Islamit dhe për një hap të pahedhur u ikën anija e shpëtimit.

*Çfarë vlere ka arsyeja dhe filozofia, të cilat, pasi e sjellin njeriun deri në pragun e shpëtimit, e pengojnë të hedhin hapin për të hyrë brenda?..<sup>6</sup>*

Përsëri ky evidentim i **Nexhip Fazëllit** është shumë kuptimplotë:

*“Institucioni që ka ndërtuar filozofia për të treguar të vërtetën, në fakt nuk është institucioni për të gjetur të vërtetën, por institucioni i korrigjimit të gabimit. Çdo shkollë filozofike trajton*





*të vërtetën, ndërsa tregon gabimin e shkollës tjetër.”<sup>7</sup>*

Ngaqë filozofia e filozofëve fetarë është si anti-helm për helmin e filozofisë ateiste dhe materialiste, nuk është e gjitha e padobishme. Është i njohur fakti që shumë antifetarë, të cilët nuk kanë pranuar asnjë argument kuranor dhe profetik, janë gjunjzuar përballë argumenteve filozofikë.

Dijetari **Bediuzzaman** është i mendimit se mendimet filozofike që janë në përputhje me Kuranin, nuk duhen refuzuar. Në lidhje me këtë, ai thotë:

*“...Filozofia, të cilën e sulmojmë kaq shumë, është pjesa e dëmshme e saj. Sepse filozofia që i shërben moralit, artit, jetës sociale dhe përmirësimit të gjendjes së njerëzimit përputhet me mësimet e Kuranit. Ndoshta është edhe shërbyese e Kuranit...”<sup>8</sup>*

Sipas Ehli Sunetit, mendja është e aftë vetëm për të kuptuar ekzistencën e Zotit, por ajo është e paaftë për të kuptuar çështjet që kanë lidhje me qenien e Zotit, atributet e Tij dhe jetën në botën tjetër.

Ashtu si arrijmë të perceptojmë me anë të mendjes disa gjëra të pakapshme për shqisat, po ashtu e vetmja mënyrë për të kuptuar disa gjëra të

7. Mistika islame dhe mendimi perëndimor, fq 14.

8. Sozler, fq.351.



pakapshme për mendjen është shpallja hyjnore.

Në këtë kontekst, **Imam Rabbani** jep një she-mbull të tillë:

*“Arsyeja e pranon që duhet falënderuar Bamirësi, por mënyra e falënderimit mund të mësohet vetëm prej pejgamberëve... Mënyra dhe shprehja e falënderimit, që nuk buron nga Allahu nuk ka asnjë vlerë tek Ai... Shumë herë njeriu përpiqet të falënderojë Allahun, sipas mënyrës së tij; kjo jo vetëm që nuk ka vlerë tek Allahu, por shpesh përdoren shprehje që nuk i kanë hije madhësisë së Allahut. E vetmja rrugë për të mësuar mënyrën e falënderimit ndaj Allahut, është shpallja hyjnore.”*<sup>9</sup>

Prandaj, mendja nuk bën dot pa shpalljen hyjnore. Pa ndihmën hyjnore mendja e njeriut është e mangët dhe e paaftë të shpëtojë nga humbja e rrugës dhe rënia në absurditete.

Jo vetëm mendimet dhe filozofia e filozofëve materialistë dhe ateistë, të cilët feja në mënyrë kate-gorike nuk i pranon, por edhe mendimet e filo-zofëve, të cilët pranojnë ekzistencën e Zotit dhe i japin rëndësi fesë duhet të kalojnë përmes sitës së shpalljes hyjnore; vetëm në këtë mënyrë mund të nxirren në pah gabimet e tyre.

Filozofia që nuk mbështetet nga feja islame nuk



mundet ta çojë dot njeriun tek e vërteta. Çështjet metafizike mund të njihen vetëm përmes fesë së vërtetë, sepse peygamberët nuk flasin nga mendja dhe sipas dëshirave të tyre. Ata përçojnë tek njeriu udhëzimet e Allahut, kurse filozofët japin direktiva individuale dhe subjektive.



## Nevoja e kriterit praktik

Në fakt, gjatë gjithë historisë së njerëzimit, asnjë shoqëri nuk e ka arritur lumturinë e kërkuar duke ndjekur dhe praktikuar mendimet e ndonjë filozofi. Mendimet e tyre nuk e kanë kaluar dot pragun e teorisë dhe në përgjithësi kanë mbetur nëpër raftet e pluhurosura të bibliotekave. Edhe ato teori filozofike për të cilat është bërë përpjekje që të zbatohen në jetë, nuk i kanë sjellë asnjë dobi dhe përfitim shoqërisë njerëzore, përveç gjakderdhjes e lotëve dhe me kalimin e kohës kanë përfunduar në koshin e mbeturinave historike.

Megjithëse **Aristoteli** hodhi disa nga themelet e moralit dhe etikës, nuk bëri të mundur të ekzistonte qoftë edhe një person i vetëm që të arrinte lumturinë duke besuar dhe zbatuar filozofinë e tij.

**Platoni** në veprën e tij të famshme “Republika” nuk arriti të shkonte përtej ilustrimit të një shteti imagjinar.



Po ashtu edhe libri i filozofit të famshëm mysliman **Farabiut** “*Qyteti ideal*”, i cili trajton krijimin e shoqërisë ideale, nuk gjeti asnjë mundësi praktikimi në jetë. Sepse këto vepra nuk përmbanin udhë-



zime të përshtatshme dhe të zbatueshme për jetën praktike.

Shembulli tipik i pamundësisë së filozofëve për t'i jetësuar mësimet e tyre është **Friedrich Nietzsche**, i cili pati ideuar “**mbinjeriun**”. Mbinjeriu i Niçes është një qenie imagjinare, e pajisur me një sërë vetish dhe cilësish joreale, e cila nuk ka ekzistuar dhe nuk do të ekzistojë. Duke qenë se *mbinjeriut* të Niçes i mungonte shembulli praktik, ai nuk gjeti asnjëherë zbatim në jetë.

Kurse Islami, përmes jetës shembullore praktike të pejgamberëve i ofron njerëzimit një sistem ideal. Cilësitë, si e drejtë - e shtrembër, e saktë - e gabuar, e mirë - e keqe, e bukur - e shëmtuar janë si etiketa, të cilat mund të përdoren në situata të ndryshme. Përderisa këto etiketa nuk mbështeten nga shembuj praktikë, gjithmonë do të ekzistojë mundësia për keqpërdorim të tyre.

Allahu e bëri Pejgamberin , një shembull dhe model të bukur për të gjithë njerëzimin. Ka mundësi që të jetë pikërisht ky shkak që Zoti e bëri atë të fillonte jetën si “fëmijë jetim”, pra si individ më i dobët brenda një shoqërie dhe pastaj e ngriti gjer në pozitat më të larta siç është pozita drejtuese dhe shpallja hyjnore. Duke qenë shembull dhe model në çdo nivel të jetës, çdo shkallë e hierarkisë shoqërore mund të gjejë tek jeta e Tij kriteret praktike të nevojshme për jetën. Pejgamberi , është një ekspozitë



e pasur, në të cilën sjelljet e tij të realizuara në përmasa ideale mund të merren për model.

Kjo është edhe arsyeja që Kurani nuk ka zbritur njëherësh, por pjesë-pjesë gjatë një periudhe 23 vjeçare, në mënyrë që pjesa e zbritur t'i përçohet umetit përmes zbatimit model të Pejgamberit ﷺ.

E gjithë jeta model e Pejgamberit ﷺ, e cila shërben si shembull konkret për të gjithë myslimanët, është e ruajtur në mënyrë të detajuar deri në ditët tona. Kjo është një mirësi e madhe e Allahut për myslimanët. Kurse *mbinjeriu* i Niçes, ngaqë i mungonte kriteri praktik, mbeti thjesht një teori utopike. Asnjë sistem moralo-filozofik, produkt i mendjes njerëzore, nuk mund të krahasohet me sistemin e përsosur të Islamit.


Të gjitha shoqëritë që kanë ndjekur mësimet e Pejgamberëve dhe dishepujve të tyre gjithmonë kanë jetuar në qetësi dhe lumturi. Allahu e ka bërë Pejgamberin ﷺ, modelin ideal për të gjithë besimtarët. Në lidhje me këtë, Allahu në Kuran thotë:


**“Në të Dërguarin e Allahut ka një shembull të mrekullueshëm për atë, që shpreson tek Allahu dhe Dita e Fundit dhe e përmend shumë Allahun.”** (Ahzab, 21)


Shumë njerëz të zhytur në injorancë dhe arrogancë në saje të moralit, sjelljes, virtytit dhe mëshirës së Pejgamberit ﷺ, janë lartësuar në majat më të



larta të virtyteve njerëzore.

Juristi i mirënjohur i jurisprudencës islame **Karafi**, e ka shprehur shumë bukur rolin edukativ të Pejgamberit :

*“Sikur Pejgamberi  , të mos kishte asnjë mrekulli tjetër, do t’i mjaftonte si mrekulli dhe provë për të vërtetuar vërtetësinë e shpalljes hyjnore brezi i njerëzve që edukoi.”*

Historiani francez **Lamartin**, do ta shprehte madhësinë dhe gjenialitetin e Pejgamberit , kështu:

*“Në qoftë se madhështia e qëllimit, pamundësia e mjeteve dhe pafundësia e rezultateve të arritura, do të ishin tri kritere për të matur gjenialitetin njerëzor, atëherë kush do të guxonte të përqaste njerëzit më të mëdhenj të kohëve moderne me figurën e Muhamedit?*

*As më të shquarit prej tyre nuk arritën veçse të ngrinin ca ushtri, ligje, perandori e të themelonin autoritete fizike të pushtimit, disa prej të cilave u rrënuan para syve të tyre.*

*Kurse Muhamedi nuk lëvizi nga vendi vetëm ushtritë, ligjet, perandoritë, popullatat, dinastitë, por edhe miliona njerëz të një të tretës së botës, për më tepër, ai lëvizi nga altarët idhujt, idetë dhe shpirtrat.”<sup>10</sup>*

---

10. A.de Lamartine, “L’histoire de la Turquie”.



Kurse shkrimtari **Thomas Carlyle** thotë:

*“Asnjë perandor nuk është respektuar dhe dashur sa Muhamedi ﷺ, i cili arronte mantelin e tij me dorën e vet .”*

Kjo ndodhte, sepse Ai nuk fliste nga mendja dhe sipas dëshirave të tij. Ai ishte përçues i shpalljes hyjnore.

Pas epokës së lumturisë, vendi ku Islami gjeti zbatimin më të gjerë dhe të plotë ishte padyshim Perandoria Osmane. Osmanët krijuan një qytetërim madhështor falë ndjekjes me përpikëri të të gjitha mësimëve profetike.

Prej qytetërimit osman mori frymëzim filozofi italian në shkrimin e veprës utopike *“Shteti i diellit”*.

Të gjitha këto tregojnë se e vetmja rrugë për të arritur lumturinë nuk është filozofia, por Islami.





## Sikur të mjaftonte arsyeja...

Allahu, i Cili e njeh natyrën njerëzore më mirë se vetë njeriu, për të kompensuar dobësinë dhe paaftësinë e mendjes në arritjen e së vërtetës gjatë gjithë historisë ka dërguar peygamberë. Sipas një transmetimi, mbi 124 mijë peygamberë, të shoqëruar me fletushka ose libra të cilët kanë shërbyer si udhërrëfyes për njerëzit në gjetjen e rrugës së drejtë. Vetë dërgimi i kaq shumë peygamberëve është një tregues i qartë i paaftësisë dhe pamjaftueshmërisë së arsyes për të gjetur të vërtetën, përndryshe Allahu nuk do të dërgonte peygamberë dhe libra gjatë historisë.

Nga ana tjetër, njeriu pavarësisht kushteve të jetës, në çdo moment është përballë frikës së vdekjes. Humbja e jetës në horizontin e vdekjes, vazhdimisht e ka trishtuar zemrën e njeriut.

Vdekja dhe jeta pas saj gjithmonë e ka preokupuar njerëzimin, por të gjitha tezat e hedhura nga mendja njerëzore në lidhje me enigmën e vdekjes dhe jetës së përtejme kanë qenë të kota për faktin e thjeshtë, sepse nuk kanë qenë të mbështetura nga drita hyjnore. Çështjet rreth vdekjes dhe jetës pas saj mund të mësohen vetëm përmes dritares së shpalljes hyjnore.



I vetmi libër hyjnor, i cili largon errësirën, zgjidh enigmat dhe të panjohurat e jetës është Kurani. Ai është i vetmi libër që kënaq arsyen dhe zemrën, logjikën dhe ndjenjën, intelektin dhe intuitën.

Allahu në shumë ajete kuranore na fton të mendojmë dhe të reflektojmë mbi urtësitë e krijimit të njeriut, mbi dizajnin e përsosur në univers dhe mbi mrekullitë e Kuranit. Ata që dëshirojnë të bëjnë një jetë të lumtur dhe të begatë janë të detyruar të hyjnë në botën e Kuranit.

Ashtu si një filiz rrap, i cili merr zhvillim marramendës në një tokë pjellore edhe zemra dhe mendja e njeriut e ushqyer nga bota e pasur e Kuranit fitojnë aftësi perceptuese dhe ndijuese marramendëse. Pa Kuranin, bota jonë e mendimeve dhe ndjenjave do të ishte shumë e varfër. Prandaj nuk ka mirësi më të madhe për njerëzimin se sa ndërgegjësimi për madhësitë e kësaj dhurate hyjnore.

Themelet e një shoqërie të shëndoshë dhe të virtytshme nuk mund të ndërtohen mbi librat e filozofisë. Filozofia asnjëherë nuk e ka realizuar lumturinë e premtuar shoqërisë njerëzore. E vetmja mënyrë për të ndërtuar një shoqëri të shëndoshë dhe të virtytshme është mbrujtja me mësimet e **Kuranit** dhe kulturën e **Sunetit**, i cili shërben si një shembull i gjallë i praktikimit të Kuranit.

Arsyerja pa udhëzimin e shpalljes hyjnore është



si një kalë i harbuar, me të cilin nuk mund të shkohet asgjëkund. Mënyra e vetme për të përfituar prej një kali të egër, është zbutja dhe vendosja e frenave, vetëm kështu mund ta përdorim për qëllimet tona. E njëjta gjë ndodh edhe me mendjen, ne mund të përfitojmë prej saj vetëm nëse ajo është nën kontrollin e shpalljes hyjnore.

Shumë rryma filozofike pretendojnë të vërtetën, por të vërtetat e mëdha mund të mësohen vetëm përmes njerëzve të posaçëm të ngarkuar me detyrë nga Allahu.

Pejgamberët janë mirësia më e madhe e Allahut për njerëzimin. Pejgamberët pa asnjë përfitim material i kanë shërbyer njerëzimit dhe përmes diturisë, sjelljeve dhe moralit të tyre kanë ndriçuar njerëzimin. Atë që njerëzimi mund të arrijë vetëm nëpërmjet një pjese të diturisë së Pejgamberëve, nuk mund ta arrijë me anë të kërkimeve mijëravjeçare filozofike.

Në këtë kontekst, **Imam Rabani** thotë:

*“Pejgamberët janë mëshirë për njerëzimin. Allahu përmes tyre na informoi rreth qenies dhe attributeve të Tij. Përmes tyre, ne mësuam dallimin e të mirës nga e keqja, të drejtës nga e shtrembra, etj. Nëse nuk do të ishin pejgamberët, mendja e njeriut nuk mund të perceptonte as ekzistencën e Allahut dhe as madhështinë e Tij.”<sup>11</sup>*

---

11. Mektubat, v. III, 23. Mektup.



Caku i arsyes, në asnjë mënyrë nuk shpreh cakun e të vërtetave. Të vërtetat vazhdojnë edhe përtej caktit të arsyes. Prirja për të arritur të vërtetat metafizike, është një prirje natyrore e njeriut. Kjo është arsyeja që, jo vetëm feja, por edhe filozofia është preokupuar seriozisht me çështjet metafizike.

Siç e kemi përmendur më lart, pejgamberët, të frymëzuar nga shpallja hyjnore, gjithmonë kanë mbështetur njëri-tjetrin, kurse filozofët, të mbështetur në arsye, gjithmonë kanë mohuar njëri-tjetrin. Filozofi gjithmonë ka refuzuar dhe kritikuar filozofin paraardhës. Kjo vjen nga që mendja njerëzore nuk mund të shpëtojë kurrë nga rreziku i gabimit, harresës dhe devijimit. Mendja gjithmonë do të jetë subjektive në gjykimet e saj, sepse ajo është nën ndikimin e një sërë faktorësh negativë ose pozitivë. Të gjitha gjykimet e arsyes janë të ngjyrosura me subjektivizëm. Arsyeja nuk është një burim i pagabueshëm njohurie.



## Sikur rruga e arsyes të ishte një...

Ekziston një tregim i njohur që tregon dobësinë e arsyes. Në Greqinë e Vjetër, sofisti i njohur **Georgias** ishte marrë vesh me një student t'i jepte mësimë private drejtësie kundrejt një shpërblimi të caktuar. Sipas marrëveshjes së lidhur mes tyre, gjysma e shpërblimit të plotë do t'i jepej mësuesit paradhënie, kurse gjysma tjetër, kur të fitonte çështjen e parë gjyqësore si avokat, sepse fitimi i çështjes së parë do të tregonte se studenti e kishte përvetësuar shkencën e së drejtës në mënyrë të përkryer. Kur përfundoi programi mësimor, studentin pretendoi se shumica që i kishte paguar mësuesit si paradhënie ishte e mjaftueshme, për pasojë, mbrojtja e parë që iu desh të bënte, ishte vetëmbrojtja përballë akuzës së mësuesit për shkeljen e marrëveshjes. Gjatë gjykimit të çështjes, Georgias e mbrojti akuzën e tij në këtë mënyrë:

“Edhe sikur ta fitoj, edhe sikur ta humb këtë çështje, kam për ta marrë pjesën e mbetur të shpërblimit!”

Gjykatësi e pyeti:

“Pse?”



Georgias iu përgjigj:

“Po ta fitoj këtë çështje, ju do të vendosni që më takon ta marr pjesën e mbetur

të shpërblimit dhe do ta marr! Kurse, po të vendosni kundër meje, do të thotë se unë e humba çështjen, kurse studenti im e fitoi! Po qe se çështjen, që është mbrojtja e parë e tij, e fiton studenti, sipas marrëveshjes, ju do të vendosni që unë ta marr gjysmën e mbetur të shpërblimit! Në të kundërt, pra, nëse nuk e marr shpërblimin, marrëveshja shfuqizohet në mënyrë arbitrare, gjë që është e pamundur!

Kundër tij, studenti bëri këtë mbrojtje me të njëjtat argumente juridike:

“Edhe sikur ta fitoj, edhe sikur ta humb këtë çështje, shumën e kërkuar nga akuzuesi s’kam për ta paguar dhe nuk duhet ta paguaj. Sepse, po ta fitoj, nuk do ta paguaj se ashtu do të jetë vendimi juaj; po ta humb, prapë nuk do ta paguaj, sepse nuk do të jetë plotësuar kushti i vënë në marrëveshje. Në të kundërt, po të merrni vendim që ta paguaj borxhin, do të keni marrë një vendim në kundërshtim me marrëveshjen, gjë që bie në kundërshtim me ligjin!<sup>12</sup>

Siç vërehet lehtësisht, pretendimi i secilit është krejtësisht i arsyeshëm dhe logjik. Ky shembull tre-



gon që nganjëherë arsyeja e shpie njeriun në rrugë pa krye. Mendja, e cila e ka të pamundur të zgjidhë shumë çështje njerëzore, nuk mund të përfshijë në domenin e saj të vërtetat e pafundme hyjnore me të gjitha përmasat e tyre. Pa ndihmën e udhëzimit hyjnor, arsyeja nuk mund t'i shpëtojë rënies në gabim.

E vetmja mënyrë për të shpëtuar nga rruga pa krye e arsyes është dorëzimi tek shpallja hyjnore dhe edukimi i arsyes me Kuran dhe Sunet.



## Pozitivizmi, simbol i absurditetit

Të gjitha pikëpamjet filozofike që mohojnë të vërtetat abstrakte të fesë mbështeten tek **pozitivizmi**. Pozitivizmi nuk pranon asnjë burim tjetër njohurie përveç shqisave.

Sipas kësaj pikëpamjeje, ekzistenca reduktohet vetëm në atë që është e kapshme për shqisat dhe që mund të provohet në kushte laboratorike. Pra, e vërtetë është vetëm ajo që perceptohet nga shqisat, çdo gjë jashtë perceptimit shqisor mohohet në mënyrë kategorike. Kurse Islami, ngaqë urdhëron edhe besimin në çështjet metafizike, për të cilat çështje shqisat janë të paafta për t'i perceptuar, ka kundërshtuar filozofinë pozitiviste.

Pozitivizmi ka dy parime themelore, por që janë në kontradiktë me njëra-tjetrën:

### 1. Përgjithësimi

### 2. Domosdoshmëria

Dhe tani, le ta shohim se si bien në kundërshtim në vetvete me njëra-tjetrën këto dy parime themelore, ku mbështetet pozitivizmi.

Parimi i përgjithësimit:

Për ta përcaktuar temperaturën e vlimit të ujit,





në laborator zihet ujë i thjeshtë (i pastër fizikisht dhe kimikisht) në shtypje atmosferike normale dhe vihet re se uji fillon të vlojë e të avullohet në një temperaturë të caktuar. Pastaj eksperimenti përsëritet dhe në të gjitha përsëritjet vihet re se uji vlon dhe fillon të avullohet po në të njëjtën temperaturë. Pastaj, duke bërë një përgjithësim, thuhet: “Në të gjithë tokën, në shtypje atmosferike normale, uji vlon në temperaturën njëqind gradë.” Kështu, ata e pranojnë këtë konkluzion të përgjithësuar pa i provuar të gjitha ujërat e thjeshta të tokës! Si rrjedhojë, induksioni i pranuar prej tyre quhet “induksion i mangët”. Po të vihet re me kujdes ky shembull, të gjitha ujërat nuk janë vënë në provë, të thuash se ky apo ai lëng avullohet në këtë temperaturë, nuk është njësoj sikur ta pretendosh këtë për të gjitha lëngjet. Këto janë konkluzione të veçanta, të ndryshme nga njëra-tjetra.

Dhe kur pozitivistët pyeten se si kanë mundur të arrijnë në këtë konkluzion të përgjithësuar pa i provuar të gjitha ujërat, përgjigjen kështu:

“Provimi i të gjitha ujërave është i pamundur, por, pasi bëmë prova të shumta e të përsëritura në laboratorin fizik dhe pasoja ishte e njëjtë në të gjitha provat, atëherë arritëm në përfundimin e përgjithshëm.”

Mirëpo, kjo është një kontradiktë për ta, sepse nuk e pranojnë vërtetësinë e një konkluzioni të



paprovuar në laborator.

Nga ana tjetër, e tillë është edhe ajo që bëjnë fetarët. Ata, pasi e shohin vazhdimin e përshtatshmërisë me mendjen (arsyen) të urdhrave fetarë, që hyjnë në fushën e vëzhgimit, pranojnë dhe miratojnë se kjo përputhje me arsyen duhet të vazhdojë edhe në çështjet që ata nuk i rrokin dot me mendje. Për shembull, një njeri i cili vëren dhe reflekton mbi procesin e krijimit nuk e ka të vështirë të kuptojë ekzistencën e jetës pas vdekjes. Po ashtu, një person që shikon sistemin e përsosur në çdo gjë, ku asnjë gjë nuk është neglizhuar, e ka shumë të lehtë të kuptojë fuqinë e Allahut për të gjykuar njerëzit në ditën e madhe të gjykimit. Pra, ai duke u nisur nga e dukshmja, mund të japë gjykime për të padukshmen.

Pozitivistët, megjithëse vetë e pranojnë këtë gjë (përgjithësimin), për fetarët e konsiderojnë të paarsyeshme dhe kështu, i mohojnë të gjitha të vërtetat metafizike. Ky është një qëndrim kontradiktor i tyre.

Në fakt, kjo kontradiktë ekziston tek të gjitha rrymat filozofike që kundërshtojnë Tevhidin. **Imam Rabbani** e shpreh kështu kontraditën në të cilën kanë rënë filozofët:

*“Është për t’u habitur me filozofët, të cilët harxhojnë gjithë jetën në mësimin e parimeve*



*logjike, në mënyrë që të jenë të mbrojtur nga rënia në gabime. Mirëpo, kur vjen puna tek çështjet madhore, si qenia e Zotit dhe atributet e Tij, ata e harrojnë shkencën e logjikës dhe fillojnë e flasin marrëzira. Kjo gjendje e tyre ngjason me gjendjen e atyre që kanë harxhuar një jetë të tërë për të mësuar armët e luftës dhe kur vjen lufta harrojnë përdorimin e tyre.”<sup>13</sup>*

Parimi tjetër i rëndësishëm i pozitivistëve është **parimi i domosdoshmërisë**. Pozitivistët, ngaqë nuk i provojnë në laborator karakteristikat në sende dhe dallimet midis tyre i quajnë:

### “Domosdoshmëri”

Por pranimi nga ana e tyre “a priori” i veçorive të pranishme në sendet e natyrës dhe dallimet mes tyre, ngaqë nuk i provojnë dot në kushte laboratorike është një kontradiktë në vetvete.

Për shembull, ata mjaftohen vetëm me përcaktimin e pasojave që vijnë nga reaksionet të cilat janë nën ndikimin e faktorëve të jashtëm, kurse shkaqet që çojnë në këto pasoja ata nuk i marrin në konsideratë, sepse janë jashtë fushës së tyre të interesit. Atyre nuk u intereson urtësia që qëndron në krijim. Kurse Islami i shpjegon të gjitha këto veçori sipas urtësisë së krijimit të tyre.

Kurani i jep direktivën çdo besimtari që lexon

---

13. Mektubat, v. III, 23. Mektup.



librin e universit: **“Lexo me emrin e Zotit tënd, i Cili krijoi** (gjithçka).” (Alak, 1) Pra, urdhëron që besimtari të orientohet shpirtërisht dhe intelektualisht nga pasoja të shkakut, nga vepra e artit tek artisti, nga krijesa tek Krijuesi. Kurani u sugjeron besimtarëve të vëzhgojnë universin në emër të Krijuesit.

Kurse filozofia materialiste e shikon ekzistencën thjesht si ekzistencë, duke e neglizhuar Krijuesin e saj. Ajo, megjithëse shikon veprën, nuk dëshiron të shikojë artistin, interesohet për pasojën, por anashkalon shkakun. Pikëpamja e mrekullueshme, elegante, e thellë dhe largpamëse e Islamit për ekzistencën përballë absurditetit, mangësive dhe shterpësisë së pikëpamjes së filozofisë materialiste, është një shembull tipik i madhësisë së botëkuptimit islam.

Në këndvështrimin Islam, e vetmja qenie absolute është Zoti, të gjitha qeniet e tjera janë relative, ekzistenca e tyre është e varur drejtpërdrejt nga Zoti. Edhe **njeriu**, që është qenia më e vlerësuar tek Allahu, nuk është absolut.

Ndërsa filozofia e vendos njeriun në epiqendër të gjithësisë dhe e konsideron atë si realitetin e vetëm absolut dhe të gjitha krijesat e tjera sillen përreth njeriut. Kjo është një pikëpamje krejtësisht egoiste. Kjo është një pikëpamje për të cilën Allahu flet në ajetin Kuranor: **“A e pe atë i cili mori për Zot egon e tij...”** (Xhathije, 23) Filozofia materialis-



te përpiqet t'i harrojë njeriut dobësinë, paaftësinë, nevojën, përkohshmërinë dhe për pasojë, veçorinë e të qenit rob i Krijuesit. Duke i reduktuar mirësitë e kësaj bote në rastësi përpiqen të mbyllin derën e falënderimit dhe madhërimit të Allahut. E gjitha kjo është qëllimi kryesor i armikut më të madh të njeriut, shejtanit.

Filozofia pozitiviste, e cila përbën bazën e kundërshtimit të fesë, ka krijuar degët e veta në të gjitha fushat e jetës. Për shembull, komunizmi në jetën ekonomike, frojdizmi në jetën seksuale etj. Të gjitha këto teori janë frymëzuar nga filozofia pozitiviste. Pozitivizmi, ngaqë është i mangët, është i refuzuar nga Islami, kurse armiqësia e tij ndaj Islamit është një absurditet në vete.



## Arsyeja, një thikë me dy presa

Ata që e konsiderojnë arsyen si zotëruese të një force të pakufishme, janë të detyruar ta pranojnë se njerëzit me arsye nuk duhet të bëjnë asnjë faj. Meqenëse arsyeja është një mjet i patëmetë dhe i aftë për të arritur të vërtetën, atëherë, çfarë e shtyn njeriun me arsye të bëjë faj? Pse të jetë autori i një akti kriminal? Mirëpo, dihet se të gjitha sistemet njerëzore, duke i dhënë dënim fajtorit, e pranojnë se ai është i shëndoshë mendërisht! Nësë formohet opiniononi se gjatë kryerjes së fajit, aftësitë mendore (të kryerësit të fajit) janë reduktuar, me fjalë të tjera, se gjatë kryerjes së fajit, fajtori nuk ka qenë i aftë mendërisht, fajtori nuk dënohet.

Kjo do të thotë që shkaku logjik i dhënies së dënimit është pranimi se gjatë kryerjes së fajit, fajtori ka qenë i shëndoshë mendërisht, domethënë, i arsyeshëm. Në këto kushte, edhe të jesh i bindur se arsyeja është një mjet i patëmetë dhe i mjaftueshëm për të arritur te akti i drejtë, te e mira edhe, megjithëkëtë, ta dënosh atë për aktin e saj kriminal, është një kontradiktë në vetvete. Kurse Islami, duke e pranuar pamjaftueshmërinë (insuficiencën) e arsyes, është i çliruar nga kjo kontradiktë e brendshme.



Me të vërtetë, arsyeja është si një thikë me dy presa. E shtyn njeriun edhe në terror, edhe në punë të mira. Pa ndihmën e arsyes nuk mund të arrihet te “përkryeshmëria e krijimit” (ahsenitakvim), por është gjithashtu arsyeja ajo që shpesh e rrëzon njeriun në një nivel më poshtë se kafshët. Prandaj duhet që arsyeja të mbahet nën disiplinë. Dhe kjo disiplinë është edukimi që bën vahji, revelata hyjnore. Po qe se arsyeja ndodhet nën kontrollin e zbulesës hyjnore, e çon njeriun në paqe dhe shpëtim. Përkundrazi, po qe se nxirret jashtë zbulesës hyjnore, e çon njeriun në fatkeqësi dhe shkatërrim. Prandaj, duhet që arsyeja të orientohet kah pëlqimi hyjnor.



## Eklipsi i arsyes

Filozofët janë përpjekur të krijojnë sisteme përmes arsyes. Mirëpo, prej këtyre sistemeve njerëzimi më shumë ka vuajtur sesa ka përfituar. Sistemet e zhvilluara prej tyre marrin në konsideratë vetëm një aspekt të prirjes njerëzore, duke i mohuar ose anashkaluar të tjerat. Duke i dhënë një rëndësi më tepër sesa duhet një prirjeje, të gjithë jetën e njeriut e kanë vlerësuar duke u bazuar tek kjo prirje. Këto quhen teori “moniste”

Për shembull, filozofi hebre **Frojd** (1856-1939), i cili zbuloi instinktin seksual, kuptoi vlerën dhe efektin e tij mbi personalitetin e njeriut dhe u përpoq ta shpjegojë jetën e njeriut të mbështetur vetëm mbi këtë shkak. Megjithëse ky konstatim i Frojdit nuk ishte krejtësisht i gabuar, por ai e ekzagjeroi duke e përgjithësuar ndikimin e instinktit seksual. Frojdi shkoi gjer atje sa të pretendonte se i vetmi faktor dhe shkak përfundimtar që shtrihet edhe nën sjelljet individuale, edhe nën sjelljet shoqërore, është instinkti seksual. Frojdi arriti deri atje, sa të shpjegonte çdo ngjarje nga mëkimi i foshnjës me gji, gjer në luftërat mes shteteve, me nevojën dhe shtytjen e instinktit seksual. Nga ky aspekt, Frojdi është bar-





tësi dhe mbrojtësi i një pikëpamjeje të mangët e të shtrembër, e cila ia ul vlerën njeriut, e cila e rrëzon dinjitetin e njeriut nën nivelin e kafshëve, e cila e sheh njeriun vetëm si një strukturë biologjike dhe elementin sundues në këtë strukturë e shpjegon me një faktor të vetëm.

Ky është dallimi midis racionalitetit të Islamit dhe racionalitetit perëndimor. Racionaliteti perëndimor nuk mund të shpëtojë nga rënia në gabim, sepse ai përpiqet ta shpjegojë jetën e njeriut me kompleksitetin e vet vetëm nga një aspekt.

Kurse Islami s'ka të bëjë me gabime të tilla. Duke i pranuar të gjithë faktorët si pjesë të jetës, Islami i vlerëson dhe i jep secilit vendin e vet, pa u dedikuar rëndësi të tepërt, më shumë se ç'duhet. Kjo është arsyeja që Islami nuk ia dedikon vetëm një faktori shkaqet që shtrihen nën sjelljet e njerëzve dhe nuk i shpjegon vetëm në një aspekt, por i mban parasysh së bashku të gjithë faktorët individualë dhe shoqërorë dhe të gjithë këtyre faktorëve u cakton një vlerë sipas gradës dhe rëndësisë që kanë.

Islami i pranon prirjet seksuale të njeriut si realitet. Islami nuk i mohon këto prirje, të cilat sigurojnë vazhdimësinë e prejardhjes njerëzore, por i rregullon dhe sistematizon. Nga njëra anë, ligjëron martesën dhe nga ana tjetër ndalon në mënyrë kategorike çdo lloj marrëdhënieje jashtëmartesore.



Të njëjtën gjë bënë edhe **Karl Marks, Darvini** dhe filozofë të tjerë materialistë, të cilët, të privuar nga udhëzimi hyjnor, e reduktuan njeriun thjesht në një qenie biologjike, duke mohuar në këtë mënyrë anën shpirtërore të tij. Kjo filozofi u bë shkak për mjerimin shpirtëror dhe social të miliona njerëzve. Komunizmi, i cili i premtoi njerëzimit mirëqenien dhe lumturinë, nuk i solli asgjë atij përveç mjerimit dhe vuajtjes.

**Karl Marksi** i dha përparësi anës ekonomike dhe të gjitha dukuritë sociale u përpoq t'i shpjegonte duke i bazuar në faktorin ekonomi. Pra edhe ai u bazua vetëm në një faktor, duke anashkaluar faktorët e tjerë. Kur arsyeja nuk udhëzohet nga shpallja hyjnore, ajo e humbet ekuilibrin. Çfarë sjell ky çekuilibrim? Për **liberalistët**, të cilët në themel të jetës kanë ekonominë, nuk ka asnjë rëndësi mënyra e fitimit. **Kapitalistët** e konsiderojnë njeriun si një ingranazh të thjeshtë të makinerisë. Kurse **komunistët** dhe **socialistët** shpenzojnë energji dhe kohë për të gjetur përkatësinë e pronës.

Të gjitha sistemet njerëzore nënvlerësojnë anën shpirtërore të njeriut.

Islami e konsideron nevojën materiale të njeriut si një realitet midis shumë realiteteve të tjera të njeriut dhe i jep rëndësinë dhe vlerën e merituar çdo realiteti, pa neglizhuar asnjërin, sepse neglizhimi i njërit sjell prishjen e ekuilibrit në tërësi. Duke e



rregulluar realitetin material të njeriut përmes udhëzimit hyjnor, Islami i ka siguruar atij lumturinë dhe qetësinë e nevojshme në këtë botë.

Sipas Islamit, prona nuk është as e individit as e shoqërisë, por e Allahut. Sunduesi absolut është Allahu, çdo gjë i përket Atij. Myslimani është thjesht një përdorues i përkohshëm i pasurisë dhe pronës së Krijuesit. Islami e ka informuar njeriun se çdo gjë materiale e kësaj bote do të mbetet në këtë botë, kurse veprimet e tij në këtë botë do të ndërtojnë botën e tij pas vdekjes. Islami e ka bërë përgjegjës individin përballë shoqërisë. Islami përmes mësimëve të tilla si:

*“Nuk është besimtar i mirë ai që fle i ngopur, kurse fqinji i tij është i uritur.”<sup>14</sup>*

*“Nuk është prej nesh ai që nuk shqetësohet për problemet e myslimanëve.”<sup>15</sup>*

i ka bërë bërë myslimanët përgjegjës ndaj njëritjetrit. Në këtë mënyrë ka realizuar në formën më të përkryer drejtësinë dhe solidaritetin social.

Ishte ky solidaritet dhe kjo drejtësi, që në periudhën e Omer Ibn Abdulazizit nuk gjendej i varfër për të shpërndarë zeqatin.

Ishte kjo atmosferë, që e nxiti shtetin Osman të krijonte mbi 26 mijë vakëfe, shoqata dhe fondacione

---

14. Hakim, II, 15.

15. Hakim, IV 352.



bamirësie. Përmes këtyre institucioneve sigurohej përmbushja e nevojave ndaj të varfërve. Në këtë mënyrë, të varfrit nuk ushqenin urrejtje, mëri dhe smirë ndaj të pasurve dhe për pasojë, sigurohej paqe dhe qetësi sociale.

Islami, si të gjitha realitetet në jetën e njeriut edhe ekonominë e ka rregulluar në atë mënyrë që t'i sigurojë individit dhe shoqërisë lumturinë e kësaj bote dhe botës tjetër.

Prandaj myslimani konsideron arsye të shëndoshë arsyen e udhëhequr nga shpallja hyjnore dhe që i shërben lumturisë së tij në këtë botë dhe botën e përjetshme. Ai vazhdimisht mban të gjallë në zemër dhe mendje qenien transhendentale, që ka krijuar dhe i jep jetë çdo qenieje tjetër. Besimtari, duke besuar në shpërblimin e ahiretit, gjen qetësinë shpirtërore, të cilën nuk mund t'ia sigurojë asnjë teori filozofike, produkt i arsyes së njeriut.

Kjo është arsyeja që shumë teori dhe veprime, të cilat racionalizmi perëndimor i konsideron logjike dhe rationale, në këndvështrimin islam konsiderohen të papranueshme. Islami nuk e konsideron arsye, arsyen e cila mohon realitetet shpirtërore, nënvlerëson mësimet e fesë dhe legjitimon shumë sjellje imorale. Arsyeja është arsye, përderisa ajo është nën udhëzimin e shpalljes hyjnore.



tën pa ndihmën e udhëzimit hyjnor, poeti e shpreh kështu:

*Prej arsyes kërkuj orientim,  
Kurse ajo më jep çorientim...*

Nga ana tjetër, nuk është vetëm arsyeja ajo që përcakton mënyrën e sjelljeve dhe veprimeve tona. Njeriu në jetë më shumë orientohet nga ndjenjat se sa nga arsyeja. Prandaj, për të arritur të vërtetën, nuk duhet të përdorim vetëm arsyen si qendër të mendimeve, por edhe zemrën si vatër të ndjenjave. Por për të arritur synimin e dëshiruar prej këtyre, duhet që të dyja të kalojnë nëpër rrugën e edukimit shpirtëror. Përndryshe, mendimet e arsyes dhe ndjenjat e zemrës nuk mund ta shpëtojnë njeriun nga fatkeqësitë. Zemra dhe arsya pa edukim shpirtëror e pandehin mjerimin mirëqenie, të shtrembrën të drejtë dhe gënjeshtrenë të vërtetë. Zemra pa besim është e pandjeshme dhe neglizhente ndaj padrejtësive, madje ajo bëhet aktori kryesor i kryerjes së padrejtësive të pashoqe. Zemra pa besim është e verbër, ajo nuk mundet ta dallojë realitetin.



## Cila arsye?

Gjatë gjithë historisë, shumë mizorë nuk kanë ndjerë keqardhjen më të vogël për krimet monstruoze dhe padrejtësitë që kanë kryer. Sepse dhuna dhe mizoritë që kanë kryer, kanë qenë, sipas arsyes së tyre, veprime të drejta dhe legjitime.

Në periudhën paraislamike në gadishullin arabik, vajzat i varrosnin për së gjalli. Një skllavopronar nuk ndjente as më të voglën keqardhje në ndërgjegjen e tij kur keqtrajtonte apo edhe vriste një skllav. Vrasja e një skllavi ishte si prerja e një cope dru. Më e keqja ishte se këto veprime i konsideronin krejt normale, legjitime dhe si një e drejtë e tyre.

Perandori i Hunëve, **Atila**, i cili u nis nga Azia e mesme dhe me pushtimet e tij arriti deri në Romë, pas pushtimeve nuk la asgjë tjetër përveç gjakut, lotëve dhe vajtimeve.

Kurse **Hulagu**, i cili pushtoi qytetin e qytetëri-meve Bagdatin, mbyti 400 mijë myslimanë të pafajshëm në lumin Tigër. Urrejtja dhe armiqësia e tij arriti deri aty sa të hidhte në lumë me qindra mijëra dorëshkrime të shkruara me aq mundim dhe lodhje. Lumi me ditë të tëra ka rrjedhur ngjyrë gjaku dhe



ngjyrë boje. Për të gjitha këto ai nuk ndjeu as më të voglën brejtje në ndërgjegje.

Edhe pushtimet e **Aleksandrit, Xhengzit** dhe **Timurit** janë të së njëjtës natyrë. Pas nuk lanë asgjë tjetër përveç gjakut, lotëve dhe britmave vajtuese.

Kurse në periudhën e afërme kemi **komunizmin**, një sistem njerëzor i ndërtuar mbi miliona trupa të vrarë. A nuk është ky sistem produkt i arsyes njerëzore që ka kryer krime nga më çnjerëzoret?

Megjithëse ata të gjitha këto krime monstruoze i konsiderojnë tepër normale dhe të ligjshme, historia i ka regjistruar si dhunë, padrejtësi dhe gjenocid kryer kundër njerëzimit.

Ndoshta këta njerëz kanë qenë ndër njerëzit më inteligjentë dhe të mençur, por inteligjenca dhe mençuria nuk u vlejti, sepse kur arsyeja privohet nga udhëzimi hyjnor, ajo në vend që t'i përdorë mundësitë për të mirën e njerëzimit, i përdor për keqtrajtim dhe robërim. Atyre u errësohet ndërgjegjja dhe u fshihen ndjenjat e mëshirës dhe dhembshurisë. Arsyeja e tyre i konsideronte krimet e kryera krejt normale, madje të domosdoshme.

Historikisht diktatorët dhe despotët i kanë dhënë të drejtë vetes për krimet e kryera, duke e kërkuar fajin gjithmonë tek të tjerët. Padrejtësitë, krimet dhe gjenocidi që po ndodh sot në botën islame, është shembull tipik i këtij mentaliteti. Ata



mendojnë se veprimet që kryejnë janë krejtësisht të drejta dhe të domosdoshme. Dhe si përfundim, nuk mendojnë aspak që kanë vrarë mijëra vetë dhe lënë miliona njerëz në mjerim dhe vajtim. Ndjeshmëria e tyre është fshirë krejtësisht, përderisa nuk mendojnë aspak për dënimin që i pret.

Të tilla panorama rrëqethëse ndodhin në çdo periudhë të historisë. Juristit të famshëm islam, **Ebu Hanifes** iu ofrua vendi i kryegjykatësit të përgjithshëm, por ai, duke qenë i vetëdijshtë për keqpërdorimin e gjykimeve të tij nga ana e drejtuesve despotë dhe të padrejtë e refuzoi ofertën. Ky refuzim i kushtoi atij dënim me burg dhe torturë. Por Ebu Hanife e pranoi me kënaqësi burgun në vend të përdorimit nga pushteti.

Arsyeja e pushtuar nga egoja dhe ambicia për këtë botë, nuk arrin të dallojë të vërtetën nga e gabuara. Sado inteligjent dhe i mençur të jetë një person i tillë, nuk mund të shpëtojë kurrë nga shturja, devijimi dhe rënia në padrejtësi.

Pushtetarët, të cilët dënimin e Ebu Hanifes e gjykuan të meritur, kurse veprimin e tyre si të drejtë, sot janë në koshin e mbeturinave historike. Madje edhe emrat e tyre janë harruar. Kurse Ebu Hanife vazhdon të jetojë në zemrat e myslimanëve dhe të marrë lutjet e tyre të singërta.





## Mendja e shëndoshë...

Historia na tregon se njerëz të tillë, si: **Faraoni**, **Nemruti**, **Atila**, **Aleksandri** dhe **Hulagu** me veprimet që kanë kryer, kanë fituar armiqësinë dhe urrejtjen e njerëzimit. Kurse njerëz të tillë, si Mevlana, të cilët kanë qenë ndriçuar nga udhëzimi hyjnor, kanë fituar dashurinë e njerëzve. Edhe pas vdekjes vazhdojnë të jetojnë në zemrat e tyre, sepse këta njerëz i kanë sjellë njerëzimit paqe, qetësi dhe mëshirë. Këta do të mbesin përjetësisht miq të njerëzimit.

Shtatë shekuj pas vdekjes, **Mevlana** vazhdon ende të jetojë në mesin e njerëzve, jo vetëm në botën islame, por edhe në perëndim. Ndër veprat që ngjallin më shumë interes në perëndim, është *Mesnevia e Mevlanës*. Kurse viti 2007 u shpall nga UNESCO si viti ndërkombëtar i përkujtimit të Mevlanës.

Për veprat e Mevlanës është shprehur një interes i madh nga qarqet humaniste në Evropë, sepse ai e trajton njeriun brenda kornizave të Kuranit dhe Sunetit, të cilët nga ana e tyre e vlerësojnë njeriun si krijesën më të nderuar në univers.

Pra, kjo vepër e shkruar me sinqeritet nga ky njeri i dashur i Allahut, akoma ngjall interes dhe



zgjoni vëmendje tek njerëzit, megjithëse është shkruar shekuj më parë. Sepse Mesnevia, duke pasuruar botën e brendshme të njeriut, ndihmon në njohjen e vetvetes dhe zgjidhjen e problemeve. Mesnevia e Mevlanës po bëhet shkak për arritjen e udhëzimit dhe gjetjen e qetësisë shpirtërore të shumë njerëzve të shtypur nga atmosfera materialiste e kohës, sepse zbraztinë shpirtërore të krijuar nga mungesa e besimit nuk mund ta mbushë asnjë lloj mirësie dhe mirëqenieje materiale.

**Mevlana** e përkufizon kështu, mënyrën për të arritur lumturinë e vërtetë:

*“Mos kujto se mendimet filozofike që burojnë nga arsyeja, imagjinata dhe natyra janë si urtësia që lind nga frymëzimi i dritës së Allahut. Filozofia vetëm se të shton dyshimet dhe pasigurinë, kurse urtësia fetare e lartëson dhe e nxjerr mbi qiej njeriun.*

*Sa keq që filozofët dhe dijetarët e djallëzuar e pandehën veten më lart se dijetarët shpirtërorë dhe të urtë. Ata nxorën teori në kundërshtim me fenë dhe në këtë mënyrë lënduan njerëzit e fesë. Ata u zhytën në marrëzira dhe punë të pavlera.*

*Ata shkartuan durimin, tolerancën, mirëkuptimin, bujarinë dhe ndjenjën e faljes, të cilat janë eliksir i lumturisë dhe mirëqenies shpirtërore.”*



## Sekreti i qetësisë shpirtërore është urtësia

**Filozofët** kanë pretenduar gjetjen e së vërtetës përmes fuqisë së kufizuar të arsyes dhe shqisave, por me këto dy mjete nuk kanë arritur të kënaqin as veten, as të tjerët.

**Apologjetikët** myslimanë e nisën rrugën duke përdorur ligjet logjike dhe analogjinë, krahas teksteve hyjnore. Por kjo u shërbeu vetëm për çështjet e juridiksionit logjik, kurse për çështjet që dilnin jashtë këtij juridiksioni, ata nuk gjetën përgjigje dhe shpesh pësuan krizë shpirtërore.

Kurse **mistikët** e vërtetë, të cilët ndoqën me përpikëri dhe bindje Kuranin dhe traditën profetike, në momentin kur përmes arsyes bëhej i pamundur udhëtimi, e vazhduan atë duke iu dorëzuar plotësisht shpalljes hyjnore. Si pasojë e kësaj bindjeje dhe nënshtrimit ndaj shpalljes hyjnore, atyre iu hapën dritaret e **urtësisë**. Shpirti i njeriut gjen qetësi dhe kënaqësi në raport të drejtë me dendësinë e urtësive që zotëron.

Aliu ﷺ, në lidhje me këtë të vërtetë thotë:

*“Qetësoni dhe freskoni shpirtrat tuaj me fjalë*



*dhe sjellje të urta, sepse, siç lodhet trupi, lodhet edhe shpirti.”*

*“Këshilloni njerëzit me fjalë të urta dhe të thella, në mënyrë që zemrat e tyre të gjejnë qetësi.”*

**Urtësia** shpreh dijen e thellë dhe të padukshme të sendeve dhe ngjarjeve.

**Urtësia** është të kuptosh paaftësinë e arsyes për të kuptuar të gjitha të vërtetat. Ka shumë gjëra, njohja e të cilave është e pamundur përmes arsyes, por krejt e njohur përmes urtësisë. Kuptimi thelbësor i manifestimeve hyjnore në univers, mund të kapet vetëm përmes syrit të urtësisë.

Nëse nuk do të ishte **urtësia**, shumë sekrete do të mbeteshin të panjohura. Kjo do të sillte privimin e zemrave nga përfitimi i kopshtit të gnosës dhe nuk do të edukoheshin personalitete monumentale, si **Mevlana, Abdulkadir Xhejlani, Junus Emre, Aziz Mahmud Hydaj** dhe të tjerë.

Urtësia buron vetëm nga zemra e pastër dhe e dëlirur nga dëshirat egoiste dhe dashuria për këtë botë. Zemra e besimtarit pastrohet dhe purifikohet në raport të drejtë me bindjen ndaj Allahut dhe të Dërguarit të Tij. Ndjekja e rrugës profetike është mënyra e vetme për të arritur grada të larta shpirtërore.

Qëllimi kryesor i diturisë është thellimi në urtësi, zgjidhja e enigmave të **Kuranit, universit dhe njeriut**, kuptimi i manifestimeve të madhështisë së



Allahut në makrounivers dhe mikrounivers.

Për shembull, shkenca e **mjekësisë** studion ligjet madhështore që Allahu ka vendosur në trupin e njeriut. Shkenca e **botanikës** merret me ligjet madhështore që Allahu ka vendosur tek bimët. Kurse urtësia merret me njohjen e Autorit që ka vendosur të gjitha ligjet dhe rregullat që studion shkenca. Qëllimi i diturisë nuk është akumulimi i njohurive, por njohja e urtësive dhe sekreteve. Njohja e urtësive dhe sekreteve arrihet vetëm përmes manifestimit të dritës së Allahut në zemrën e besimtarit.

Allahu thotë në Kuran:

***“Ai ia jep urtësinë (të kuptuarit e Kuranit) kujt të dojë. Cilitdo që i është dhënë urtësia, vërtet që i është dhënë një mirësi e madhe. Por këtë nuk e kupton tjetërkush, përveç njerëzve të mençur.”*** (Bekare, 269)

Njerëzit e urtë, deri sa ishin gjallë, u kanë dhënë zgjidhje të plotë problemeve të njerëzve përmes shembullit praktik, kurse mbas vdekjes vazhdojnë të mbajnë gjallë e japin zgjidhje problemeve të tyre përmes kryeveprave që kanë lënë pas.

Dijetari i shquar islam i shekullit të kaluar, **Muhammed Hamidullah**, thotë kështu:

*“Mënyra se si jam rritur dhe përgatitur unë, është racionale. Kërkimet dhe studimet juridike m’i kanë hedhur poshtë të gjitha gjërat e papër-*



shkruara e të pavërtetuara në mënyrë bindëse. Pa dyshim, unë i kryej detyrat islame, si: namazi, agjërimi, etj., jo për shkaqe mistike, por juridike. Dhe them me vete:

“Allahu është Zoti im, është Krijuesi im. Ai më ka urdhëruar për t’i kryer këto. Pra, më duhet t’i kryej. Veç kësaj, të drejtat dhe detyrat janë të lidhura me njëra-tjetrën. Allahu m’i ka urdhëruar këto, me qëllim që të përfitoj prej tyre. Atëherë, unë e kam për detyrë ta falënderoj Atë!”

Qysh nga koha kur fillova të jetoj në shoqërinë perëndimore, në një mjedis të tillë si Parisi, nisa të shoh me habi se ajo që i shtyn të krishterët ta pranojnë Islamin, nuk janë pikëpamjet e dijetarëve të fikhut e të kelamit, por mistikë të tillë, si: **Ibn Arabi** dhe **Mevlana**. Mbi këtë çështje edhe unë formova përvojën time personale. Kur më kërkohet shpjegimi i një çështjeje islame, përgjigjja ime e mbështetur në argumente racionale, domethënë, në arsyen, nuk e kënaqte personin që bënte pyetjen, kurse shpjegimi mistik nuk vononte të jepte fryt. Kështu, me kohë, unë e humba forcën ndikuese dhe tani besoj se të paktën në Europë dhe Afrikë, ajo që do t’i shërbejë Islamit nuk është as arsyeja, as shpata, por zemra, domethënë, tasavvufi!

Pas kësaj përvoje, fillova të studioja disa vepra të shkruara mbi tasavvufin. Kjo ma hapi



*syren e zemrës. Dhe e kuptova se tasavvufi dhe rruga e mistikëve të mëdhenj islamë në kohën e Profetit, qe jo marrja me fjalë dhe as preokupimi me gjëra të pakuptim, por ecja në rrugën më të shkurtër, që shkon nga njeriu te Zoti, kërkimi i rrugës së zhvillimit të personalitetit.*

*Njeriu kërkon shkaqet e detyrave që i ngarkohen. Shpjegimet materiale në fushën shpirtërore na largojnë ne nga synimi; vetëm shpjegimet moralo-shpirtërore janë ato që e kënaqin njeriun!”<sup>16</sup>*

Prandaj, përgjigjja që kënaq të gjithë njerëzit është tek prijësit e zemrave, të cilët, krahas ligjeve logjike dhe arsyes, përdorin edhe urtësinë hyjnore për të komunikuar me njerëzit.

Gnostikët pasqyrojnë atmosferën e një zemre të edukuar dhe selitur nga shpallja hyjnore. Ata e dinë shumë mirë që një mendje jashtë kontrollit të shpalljes hyjnore është e destinuar të pushtohet nga mendjemadhësia dhe mburrja, në këtë mënyrë ajo del jashtë qëllimit për të cilin është krijuar, duke e nxitur njeriun drejt devijimeve dhe kurtheve të shejtanit. Në lidhje me këtë, **Mevlana** thotë:

*“Sikur shejtani të kishte edhe zemrën të çelur si mendjen, nuk do të ishte në këtë gjendje që është sot.”*

---

16. Metinlerle Gunumuz Tasavuf Hareketleri, fq. 542-543.



Kundërshtimi i parë i arsyes ka qenë kundër Krijuesit të saj, Allahut Teala. Arsyēja e orientoi shejtanin në analogji të gabuar, e cila u bë shkak për dëbimin e tij përfundimisht nga xheneti dhe mëshira hyjnore.

Bota është e mbushur plot me djaj, kundërshtarë të urdhëresave hyjnore. Pëshpëritjet e shejtanit i duken njeriut mëkatar si urtësi. Mirëpo, aftësia dhe urtësia e vërtetë është mbështetja e plotë tek Allahu, duke u mbrojtur nga dredhitë e shejtanit.

**Mevlana** e shpreh kështu, rëndësinë e dorëzimit të plotë tek shpallja për çështjet që janë përtej kufijve të arsyes njerëzore:

*“Intelekti, megjithëse është faktor i rëndësishëm për suksesin tonë në çështjet tokësore, është i paaftë për të arritur urtësitë dhe sekretet hyjnore. Për këtë udhëtim shpirtëror është e domosdoshme ndihma e zemrës dhe dashurisë.”*

Pamundësinë për të arritur të vërtetat hyjnore pa pastruar zemrën dhe pa shpëtuar nga vargonjtë e egos, Muhamed Ikbali, në mënyrë figurative e shpreh kështu:

*“Një natë, në bibliotekë dëgjova një molë duke i thënë fluturës:*

*- Lexova librat e Ibn Sinës, shfletova librat e Farabiut, por filozofinë dhe artin e jetës nuk e gjeta, nuk kam një diell të më ndriçojë ditët...*





*Përballë shqetësimit të molës, flutura i tregon krahët e djegur, duke i thënë:*

*- Shiko, unë i dogja krahët për këtë dashuri-pastaj vazhdoi më tej:*

*- Ajo që e bën jetën të gjallë dhe të larmishme është puna dhe dashuria*

*Flutura, duke i treguar krahët e djegur, donte t'i thoshte:*

*- Shpëtoje veten nga humbja në rrugë pa krye, duke u ushqyer nga atmosfera e flaktë dhe plot dashuri e Mesnevisë!..”*

Për të ndriçuar zemrën dhe mendjen, duhet të rrotullohemi gjithë dashuri rreth burimeve të urtësisë hyjnore, si një flutur që rrotullohet rreth dritës. Vetëm në këtë mënyrë mund të shpëtohet nga udhëkryqi i arsyes dhe të arrihet qetësia dhe lumturia. Njeriut që zgjidhet nga vargonjtë e egos dhe interesave materiale, i hapen horizontet shpirtërore dhe qiellore.



## Krahët e shpirtit

Një besimtar ka nevojë për dritën dhe urtësinë hyjnore në çdo periudhë të jetës. Përndryshe, është shumë e vështirë të kalohet nga sipërfaqësorja tek thelbësorja, nga forma tek përmbajtja.

**Abdulkadir Keçeoglu** thotë:

*“Për të arritur lartësitë qiellore, është e domosdoshme dashuria dhe ibadeti. Dashuria pa ibadet dhe ibadeti pa dashuri, është si një zog me një krah.”*

Ashtu si janë të domosdoshëm krahët për të fluturuar edhe dashuria është e domosdoshme për besimin dhe ibadetin. Arritja e përsosjes shpirtërore është e mundur vetëm përmes dashurisë dhe entuziazmit ndaj ibadetit.

Ishte kjo dashuri e zjarrtë, që i bëri sahabët që përballë çdo urdhërese të thoshin: **“Dëgjuam dhe u bindëm.”** Ata ishin të gatshëm të jepnin jetën pa asnjë ngurrim dhe mëdyshje për Pejgamberin ﷺ.

Kur i Dërguari i Allahut ﷺ, u tha: *“Kush do t’ua dërgojë letrat mbretërve?”*

Asnjëri nga shokët e Tij nuk tha: *“Është rrugë e gjatë, me çfarë do të iki, ata mund të më vrasin”*, por



me një dëshirë të zjarrtë dhe në mënyrë vullnetare kërkuan të kryenin këtë shërbim sublim.

Kjo gatishmëri e tyre vinte nga urtësia që kishin fituar prej edukimit profetik. Ata kishin kaluar nga “**akl-i meash**” në “**akl-i mead**”<sup>17</sup> Pasuria e kësaj bote në syrin e tyre nuk kishte asnjë vlerë. Ata ishin të dhënë me gjithë qenien e tyre pas fitimit të dashurisë së Allahut dhe të Dërguarit të Tij. Megjithëse bënë një jetë të varfër dhe të vështirë, ata arritën që epokën e tyre ta shndërronin në epokën e lumturisë dhe të hidhnin themelet e qytetërimit të virtyteve. Ka shumë njerëz që janë të rrethuar nga vështirësitë, por që jetojnë në kopshtet e lumturisë dhe ka shumë njerëz që, megjithëse kanë të gjitha të mirat materiale, jetojnë një jetë të mjerueshme dhe të palumtur.

Ky është shkaku që në shoqërinë e epokës së lumturisë nuk hasim asnjë krizë psikologjike apo shpirtërore. Në asnjë literaturë të asaj kohe nuk hasim raste të krizave psikologjike. Madje, nuk dihet që Pejgamberit ﷺ, t'i jetë bërë ndonjë pyetje rreth kësaj teme.

---

17. Dijetarët islamë e ndajnë mendjen (arsyen) në dy lloje: “akl-i meas” dhe “akl-i meâd”. Lloji i parë është për t'i kuptuar punët e kësaj bote, gjë për të cilën ka aluduar Profeti me hadithin profetik “Punët e kësaj bote ju i dini më mirë”. (Muslim, Fedail, 141) Kurse lloji i dytë është mendja (arsyeja) e aftë për të konceptuar punët e ahiretit, jetës pas ringjalljes, të cilat lloji i parë s'i koncepton dot.



Një besim i gjallë dhe një ibadet me entuziazëm, në të njëjtën kohë është edhe një terapi efektive kundër sëmundjeve psikologjike dhe shpirtërore. Përmes një jete shpirtërore të gjallë dhe të zjarrtë, të gjitha problemet dhe vështirësitë që mund të hasen në jetë, kapërcehen lehtë dhe pa pasoja. Ata përmes dorëzimit dhe strehimit tek Allahu, gjenin lumturi dhe qetësi shpirtërore.

Allahu në Kuran e tregon nënshtrimin, bindjen dhe gatishmërinë e sahabëve ndaj fesë së tyre si model ideal për gjithë bashkësinë islame, për të arritur pjekurinë dhe përsosjen shpirtërore.



## Sakrifikimi i arsyes përballë shpalljes

Ne sot jemi dëshmitarë të dobësisë sonë për të hequr dorë për hir të Allahut nga dëshirat dhe llogaritë materialiste të mendjes. Ashtu si pejgamberët dhe ndjekësit e tyre edhe ne duhet t'i thyejmë idhujt brenda nesh, të cilët na pengojnë në udhëtimin tonë drejt Krijuesit. Ashtu si shokët e Pejgamberit ﷺ edhe ne, në vend të llogarive të mendjes, duhet të tregojmë gatishmëri dhe bindje në kryerjen e detyrimeve dhe shërbimeve fetare.

**Mevlana** e shpreh kështu këtë:

*“Duhet t'i sakrifikojmë llogaritë dhe arsyetimet në lidhje me të mirat e kësaj bote për Pejgamberin ﷺ.”*

Mendimtari i madh islam, **imam Gazaliu**, thotë kështu:

*“Pasi i dhashë fund punës intensive pas fazave të analizës, kritikës dhe njohjes filozofike, duke u nisur nga synimi im, e kuptova se edhe kjo shkencë është e pamjaftueshme, se arsyeja është e papërshtatshme për ta rrokur dhe kuptuar çdo gjë e vetme, se ajo s'ka për ta ngritur dot perden*



*e fshehtësisë së lëshuar para çdo gjëje!”<sup>18</sup>*

Situatën e Gazaliut mes fushave të arsyes dhe intuitës shpirtërore, **Nexhip Fazëll Kësakyrek** e tregon kështu në një vepër të vetën:

*“Ky burrë i madh i mendimit, që përmendet si “argument i Islamit”, kur i la mënjanë tërë punët e mendjes dhe arsyes dhe u drejtua kah intuita e vërtetë shpirtërore, tha kështu: “...dhe pashë se e vërteta është mbështetje në begatinë shpirtërore të Profetit të profetëve, kurse çdo gjë tjetër është vetëm gënjeshtër, fantazi dhe iluzion. Kurse arsyeja, vetëm kufi!..”*

*Dhe kjo kokë e madhe dhe e pashoqe, duke i shuar të gjitha pyetjet, u mbështet dhe u strehua në begatinë shpirtërore të Profetit të profetëve dhe e gjeti të pakufishmen!”*

Nëse njeriu i jep rëndësi më shumë se sa duhet arsyes dhe pushtohet nga iluzioni se ajo është e vetmja rrugë për të arritur të vërtetën, atëherë atij i mbyllet dyert e zemrës dhe shpirtit. Në këtë mënyrë, arsyeja bëhet një lodër e egos, kurse bota shpirtërore paralizohet.



## Pasqyra e së vërtetës

Çdo njeri e ka të nevojshëm kalimin përmes edukimit shpirtëror. Ai ka nevojë për një pasqyrë, në të cilën të shikojë mangësitë dhe të bëjë përpjekje për të përmirësuar gjendjen e tij.

Pasqyra për myslimanët është Kurani, Suneti dhe ndjekësit e sinqertë, të devotshëm dhe të përkushtuar të Pejgamberit ﷺ. Pa udhëzimin dhe orientimin e tyre, njeriu nuk mund të shpëtojë nga devijimi, shturja dhe sëmundjet shpirtërore.

Sa bukur e tregon në Mesnevi, **Mevlana** këtë:

*“O ti që e pandeh veten të mjaftueshëm! Nuk mund të ketë sëmundje më të keqe në shpirtin tënd, sesa iluzioni i vetëmjaftueshmërisë...”*

Për të shpëtuar nga çorientimi i arsyes, është i nevojshëm kalimi përmes edukimit kuranor dhe profetik.

Ndërsa arsyeja reflekton mbi Kuranin, i cili shërben si pasqyrë e njeriut dhe universit, nxjerr përfundime, të cilat kanë nevojë të përpunohen prej një zemre të dashuruar pas besimit.

Zemra është vatër e ndjenjave. Kur ajo pastrohet dhe në të vendoset vetëm dashuria për Allahun,



aço na jep një pasqyrim të saktë dhe të qartë të realitetit të gjërave.

Kurani është si një oqean pafund, kurse njeriu është notar. Një njeri që nuk di not, noton në breg të oqeanit, kurse një notar i zoti noton në thellësi, duke zbuluar në këtë mënyrë gjëra interesante, të cilat ai që noton në breg i ka të pamundura t'i shikojë. Besimtari i devotshëm, gjatë leximit dhe reflektimit mbi Kuranin, dallon urtësi të panumërta, të cilat nuk mund t'i dallojë një besimtar me zemër të shkujdesur. Zembrës së thelluar në kuptimet e Kuranit i hapen horizonte qiellore.

Filozofët që kanë tentuar ta shpjegojnë çdo gjë me anë të arsyes, as veten nuk e kanë vënë dot në rrugë të drejtë, as ndjekësit. Fundja, po qe se arsyeja do të ishte në gjendje t'i zgjidhte të gjitha, nuk do të kishte nevojë për profetët, udhërrëfyesit, treguesit e udhës së drejtë. Prandaj arsyeja ka nevojë për udhëheqjen e vahjit, zbulesës hyjnore.

Disa filozofë, që e kanë kuptuar paaftësinë e arsyes për të gjetur këtë të vërtetë, bashkë me pohimin e dobësisë së arsyes, janë vënë të kërkojnë mjete të tjera për gjetjen e së vërtetës. Filozofia në përgjithësi, mbetet ende një kundërshtar e shpalljes hyjnore.

Një nga filozofët që e ka pranuar intuitën si burim njohurie, është edhe filozofi francez, **Henri Bergson** (1859-1941). Por rastet si të Bergsonit janë





sporadike në historinë e filozofisë. Pranvera nuk vjen me një lule, për më tepër që edhe **Bergsoni** nuk arriti ta përsoste teorinë e tij, për shkak të ndikimit të krishterë dhe privimit nga mesazhi islam.

Ashtu siç pësojnë shastisje rrugës ata që mbësh-teten vetëm tek arsyeja për të gjetur të vërtetën edhe ata të cilët arrijnë një gjendje të arrirë shpirtërore përmes ushtrimeve dhe disiplinave të ndryshme të paparashikuara nga mësimet e fesë, janë gjithmonë të rrezikuar nga shastisja dhe devijimi. Është shpallja ajo që vendos dhe bën dallimin midis asaj që është inspirim hyjnor dhe johyjnor.

Në lidhje me këtë, **Imam Rabbani** bën këtë qortim:

*“Metoda e ushtrimeve dhe disiplinave shpirtërore është e njëjtë me metodën e arsytimit logjik. Ashtu si arsyeja e vetme nuk mund të na sigurojë arritjen tek e vërteta edhe ushtrimet dhe disiplinat shpirtërore dhe mistike nuk mund të na çojnë dot tek Allahu. Informacionet e pejgamberëve janë të mbrojtura nga ndërhyrjet e shejtanit. Në lidhje me pamundësinë e shejtanit për të ndikuar mbi pejgamberët, Allahu në Kuran thotë: “**Në të vërtetë, ti nuk do të kesh pushtet mbi robërit e Mi, përveçse mbi të humburit, që të pasojnë ty.**” (Hixhr, 42)”<sup>19</sup>*

---

19. Mektubat, fq. III, 23. Mektup.



## Devijimet akademike

Me shumë keqardhje, çdo ditë e më shumë po konstatojmë teologë, të cilët përballë gjithë këtyre të vërtetave të pakontestueshme, ende vazhdojnë ta konsiderojnë filozofinë dhe arsyen mbi shpalljen hyjnore dhe traditën profetike, duke nënvlerësuar në këtë mënyrë Kuranin, fjalën e Allahut dhe hadithin, fjalën e Pejgamberit ﷺ.

Në syrin e tyre, një teolog që nuk ka lexuar dhe nuk ka njohuri rreth filozofisë, konsiderohet i pamjaftueshëm, madje injorant. Sipas tyre, shkencat islame janë të pakonceptueshme pa ndihmën e filozofisë.

Nën pushtimin e ndjenjës së inferioritetit, ata lartësojnë deri në hyjnizim filozofinë, duke e vlerësuar atë si gjykatësen e të gjitha shkencave, si shkencën e cila filtron shkencat e tjera, duke përfshirë edhe shkencat fetare nga gabimet dhe mangësitë. Por si mundet filozofia të gjykojë mbi fenë, kur feja qëndron më lart se ajo. Ndërsa thelbi i filozofisë është arsyeja, thelbi i fesë është besimi, i cili shikon rrugën, të cilën arsya nuk e shikon dot.



pseudoteori të tilla, sikur shpallja hyjnore ushtron karakter frenues mbi arsyen dhe procesin e të menduarit.

Këtë mentalitet **Mevlana** e ka qortuar shumë shekuj më parë, duke thënë:

*“Të paktën, mos akuzo trëndafilin për paaftësinë tënde për të nuhatur aromën e tij.”*

Mos akuzo Kuranin për paaftësinë tënde për të hyrë në atmosferën meditative të urtësive të panurmërta dhe të vërtetave pa fund të Tij, por gabimin shikojë tek vetja jote. Si mund të akuzohet Islami për frenues të mendimit, kur shumë ajete kuranore urdhërojnë dhe nxisin për reflektim dhe mendim.

Është shumë i lehtë udhëzimi dhe korigjimi i gabimit për një person që është i vetëdijshëm për injorancën, por është shumë i vështirë për një person që e pandeh veten dijetar apo filozof. Angazhimi me filozofi, pa u thelluar mirë në shkencat, çon në çorientim dhe keqkuptim të teksteve fetare, gjë e cila është shumë e vështirë për t'u kuruar, sepse i sëmuri e pandeh veten të shëndetshëm. Në lidhje me këtë lloj njerëzish, **Bediuzamani** thotë:

*“Dikur, çorientimi dhe shtrembërimi, të cilët janë të lehtë për t'u kuruar, vijnë nga injoranca, kurse sot çorientimi dhe shtrembërimi, të cilët janë të vështirë për t'u kuruar, vijnë nga filozofia dhe pseudodijetarët. Mundësia e pranimit të*



*paditurisë në grupin e dytë, është një në njëmijë, sepse njerëz të tillë janë injorantë, por e pandehin veten për dijetarë.*”<sup>20</sup>

Për më tepër që, sipas Islamit, dituria, e cila nuk pasqyrohet në moral dhe sjellje nuk ka asnjë vlerë. Allahu në Kuran i ngjason njerëzit, të cilët mburren me diturinë e tyre teorike pa bërë asnjë përpjekje për ta zbatuar në jetë, me gomarin që mbart libra mbi kurriz.


**“Shembulli i atyre, që iu besua Teurati, por pastaj nuk e zbatuan atë, i shëmbëllen gomarit, që vetëm sa i mbart librat. Sa i keq është shembulli i atyre që mohojnë shpalljet e Allahut! Allahu nuk i udhëzon (në rrugën e drejtë) keqbërësit.”** (Xhuma, 5)

Një tjetër devijim akademik, i cili vjen si rrjedhojë e ndikimit perëndimor dhe i mbivlerësimit të filozofisë kundrejt shpalljes, është përhapja e fenomenit të historizmit nëpër fakultetet teologjike.

Kjo rrymë ka hapur një debat të fortë, duke mohuar karakterin universal të ajeteve të Kuranit. Kjo rrymë, duke i kufizuar disa dispozita hyjnore vetëm në kontekstin kohor dhe hapësinor në të cilën janë shpallur, ka shkaktuar pështjellim dhe trazirë të madhe në besimin e njerëzve. Sipas tyre, një pjesë e dispozitave kanë qenë të vlefshme për kontekstin



historik në të cilin ka zbritur Kurani, kurse një pjesë tjetër i referohen vetëm arabëve, pra kulturës arabe. Përmes filozofive të tilla të shtrembëra përpiqen të zhveshin Kuranin nga karakteri i tij universal dhe gjithëpërfshirës.

Sikur të mos mjaftonte kjo, këta i kanë njohur vetes të drejtën për të ndërhyrë në dispozitat parimore, e drejtë e cila nuk i është njohur as Pejgambeirt .

Në fakt Islami, për t'u dhënë zgjidhje problemeve të njerëzimit përballë ndryshimit të kushteve shoqërore ndër shekuj, njeh të drejtën e përdorimit të argumenteve logjike dhe tekstuale, për të nxjerrë dispozita nga përmbajtja e Kuranit dhe Sunetit. Por kjo e drejtë është vetëm për ata dijetarë që kanë arritur gradën e muxhtehidit, madje edhe kjo e drejtë e tyre është vetëm për çështjet ku nuk ekziston dispozitë kategorike, sepse në çështjet për të cilat ekziston dispozitë e prerë, në asnjë mënyrë nuk lejohet ixhtihadi. Për shembull, në të drejtën e trashëgimisë, për të cilën ka dispozita kategorike, në asnjë mënyrë nuk lejohet ixhtihadi.

Sipas ithtarëve të historizmit, të gjitha këto janë të diskutueshme. Ky guxim prej injoranti i tyre, të kujton shtrembërimin që u është bërë më herët Teuratit dhe Inxhilit.

Urdhëresat dhe ndalesat në Islam janë përcaktuar mbi bazën e veçorive të pandryshueshme të



natyrës së njeriut. Këto dispozita janë përsosmërisht të afta për të zgjidhur të gjitha problemet e njerëzimit, në çdo kohë dhe vend deri në Ditën e Kiametit.

Prandaj dispozitat e Kuranit nuk vjetërsohen dhe nuk i humbasin vlerat kurrë. Ato e ruajnë vazhdimisht aftësinë e mrekullueshme për t'iu përgjigjur nevojave të njerëzimit. Prandaj pretendimi se një pjesë e ajeteve kuranore janë historike, janë të vlefshme vetëm për një kohë dhe vend të caktuar, është një shtrembërim që shkon deri në herezi.

Sa herë që ndryshonte gjendja sociale e shoqërisë, Allahu vendoste përmes dërgimit të peygamberëve dispozitë. Ndërsa dispozitat teorike të besimit nuk ndryshonin në varësi të shoqërisë, dispozitat praktike ndryshonin sipas shoqërisë. Muhamedi ﷺ, është peygamberi i fundit, pas Tij nuk do të vijë tjetër peygamber. Prandaj dispozitat që ka sjellë Ai, janë të afta të përballojnë të gjitha nevojat e njerëzimit deri në Ditën e Kiametit.

Është një shtrembërim shumë i rrezikshëm t'i mveshësh Allahut dobësi në përcaktimin e dispozitave ndaj njerëzve të Tij, i cili i njeh më mirë se ata veten e tyre. Është një marrëzi, që i ngjason përfshirjes së shejtanit në debat me Krijuesin e gjithësisë.


Nga kjo pikëpamje, nuk mund të ketë situatë më absurde dhe të marrë, sesa guximi për të diskutuar



dhe vënë në dyshim dispozitat e Allahut përmes peshores së arsyes, të cilën Allahu vetë ia ka dhuruar njeriut si mirësi ndaj tij. Kurse ai, arsyen e dhuruar nga Allahu e përdor për të vënë në dyshim fjalën e Tij. Atyre që bien në një marrëzi të tillë, duhet t'u kujtojmë ajetet:

***“Thuaju: ‘Vallë, a do ta njoftoni Allahun për fenë tuaj, ndërkohë që Ai di gjithçka që përmbajnë qiejt dhe Toka?! Allahu është i Dijshëm për çdo gjë.’*** (Huxhurat, 16)

***“...Mos vallë, një pjesë të Librit (Teuratit) e besoni, kurse pjesën tjetër e mohoni?! Cilido prej jush, që vepron kështu, do të ndëshkohet me poshtërim në këtë jetë, ndërsa në Ditën e Kiametit do të dërgohet në dënimin më të ashpër. Allahu nuk është i pavëmendshëm ndaj veprimeve tuaja.”*** (Bekare, 85)

Kurse **Pejgamberi**  thotë:

*“Kurani është një fjalë e atillë hyjnore, e cila e mbron njeriun prej çfarëdo lloj intrige dhe trazire që mund të ndodhë. Në të gjenden të dhëna historike për popujt para jush, informacione për popujt pas jush dhe dispozita e parime për ngjarjet që do të ndodhin midis njerëzve. Ai bën dallimin midis të drejtës dhe të shtrembrës. Kush e braktis atë, Allahu e shkatërron dhe kush kërkon udhërrëfyes tjetër përveç Kuranit, Allahu e kredh*



*në rrugë të gabuar dhe të shtrembër...*” (Tirmidhiu, Fedailul Kuran, 14/2906)

Përhapja e gjithë këtyre pështjellimeve në botën islame është tregues i qartë i injorancës së madhe që mbizotëron kudo rreth shkencave themelore islame. Nismëtarët e këtyre pështjellimeve janë pseudodijetarët, të cilët kanë bërë karrierë akademike, pa pasur një formim teologjik bazë, pa reflektuar si duhet mbi Kuranin dhe Sunetin dhe pa lexuar si duhet një libër tefsiri. Kurse teoritë e hedhura prej tyre nuk janë gjë tjetër përveçse shprehje fatkeqe e mahnitjes dhe dashurisë që ushqejnë ndaj ideologjive të shtrembëra perëndimore.

Sikur të kishin reflektuar dhe studiuar si duhet Kuranin dhe Sunetin, do ta kishin kuptuar që situata nuk është ashtu si e mendojnë ata, duke shpëtuar në këtë mënyrë nga batakua në të cilin janë zhytur. Allahu në 137 vende në Kuran i fton njerëzit të reflektojnë, të mendojnë dhe të studiojnë mbi urtësitë dhe të vërtetat hyjnore. Për më tepër që horizontin meditativ që hap Kurani, nuk mund ta arrijë për mijëra vjet një mendje e privuar nga shpallja hyjnore. Vetëm me ndihmën e shpalljes hyjnore mund të hapen horizontet shpirtërore.

Një dijetar islam, që t’i shërbejë si udhërrëfyes njerëzimit, duhet të thellohet në reflektim dhe të ketë njohuri mbi shkencat e logjikës, psikologjisë, matematikës, politikës dhe etikës. Është detyrë e çdo





mbartësi dhe përcuesi të mesazhit islam të pajiset me njohuri të mjaftueshme rreth filozofisë dhe rrymave të saj, në mënyrë që në rast nevoje, të jetë i aftë për t'iu përgjigjur sulmeve të ndryshme që bëhen kundër Islamit. Mësimi i filozofisë dhe rrymave të saj pas zotërimit të plotë të mësimëve kuranore dhe profetike nuk është aspak i dëmshëm, përkundrazi, një intelektual mysliman, i cila ka marrë përsipër mbrojtjen e kauzës islame, duke mësuar dhe studiuar botëkuptimet e tjera, kupton më mirë vlerën dhe madhështinë e Islamit përballë tyre. Kjo bëhet shkak për forcimin e besimit, sepse e vërteta është më e dallueshme dhe e qartë përballë të kundërtës së saj.

Mendimtari dhe poeti **Nexhip Fazëll** thotë:

*“Besimi më i fortë është besimi i atyre që njohin mirë burimet e mosbesimit. Informimi rreth të shtrembrës është obligim për çdo mysliman... Nuk mjafton të thuash unë jam armik i komunizmit, duhet ta kuptosh dhe studiosh atë...”<sup>21</sup>*

Një notar profesionist mund të notojë në ujëra të thella pa frikë, duke shijuar në këtë mënyrë bukuritë e nënujore. Nuk ka asnjë problem për një besimtar cilësor, i cili ka njohuri të mjaftueshme rreth fesë së tij, të shëtisë nëpër kulturat e popujve të tjerë. Problem është të notosh në ujëra të thella pa ditur not. E rrezikshme është të përballësh me kulturat,

---

21. Mistika islame dhe mendimi perëndimor, fq 69



botëkuptimet dhe rrymat e tjera filozofike, pa pasur njohuritë e duhura rreth Islamit. Në këtë rast ekziston rreziku për të mbetur nën ndikimin e tyre.

**Imam Gazaliu** bën lidhje me këtë rrezik:

*“Njeriu i zgjuar, së pari njeh të vërtetën, pastaj shikon fjalën. Nëse fjala është e drejtë, e pranon, për atë nuk ka rëndësi se kush e ka thënë fjalën e drejtë, e rëndësishme është fjala, jo autori i saj. Ai shkon përtej kësaj, duke kërkuar fjalën e drejtë, të humbur dhe të përzier midis fjalëve të kota dhe të shtrembëra. Sepse ai është i vetëdijshëm që ari gjendet i përzier me dhe.*

*Një kambist i aftë nuk ka frikë të bëjë tregti me një falsifikator kartëmonedhash, sepse ai menjëherë e dallon monedhën false nga e vërteta. Ai që humbet nga tregtia me një falsifikator është injoranti...*

*Shumë njerëz e pandehin veten të aftë dhe ekspertë të dallimit të së vërtetës nga e gabuara. Prandaj veprat e jomuslimanëve duhen evituar nga rënia në duart e njerëzve të tillë, të paaftë për ta dalluar të vërtetën.”<sup>22</sup>*

Siç kuptohet lehtësisht nga evidentimi i Imam Gazaliut, rreziku i filozofisë qëndron në mundësinë e përzierjes të së drejtës me të shtrembrën dhe të së gabuarës me të saktën, çka sjell rënie në gabime



besimi. Orientalistët e ditëve tona gjatë vlerësimit të fesë islame, për të përhapur ideologjinë perëndimore, e ambalazhojnë një të shtrembër midis dhjetë të vërtetave. Në saje të kësaj taktike, ata rrezikojnë besimin dhe Tevhidin e atyre që nuk kanë formimin e duhur dhe janë të privuar nga mburoja e devotshmërisë.

Për sa i përket çështjeve të besimit, nuk duhen toleruar mendimet orientaliste apo filozofike, sado të pakta qofshin, sepse për të dëmtuar Tevhdin, mjafton, madje tepron një mendim i gabuar.

Kjo ndodh për shkak se Tevhidi nuk toleron fragmentarizmin, ai vlen si një i tërë dhe jo në gjendje të fragmentuar. Për nga pasoja që sjell nuk ka ndryshim midis atij që mohon gjithë Kuranin dhe atij që mohon një ajet të tij. Të dyja rastet e nxjerrin individin nga rrethi i besimit.

Për shkak të këtij rreziku, përveç dijetarëve të aftë për të dalluar gabimet angazhimi i njerëzve të tjerë me vepra jo të sigurta është konsideruar i dëmshëm. Personat që nuk kanë formimin e duhur teologjik, janë më të rrezikuarit përballë sulmeve dhe kurtheve të kurdisura me mjeshtëri, jo vetëm nga orientalistët, por fatkeqësisht edhe nga mesi i myslimanëve.

Përkundrajt gjithë këtyre, mund të themi se personi i cili e bën kauzë të tij Islamin, përveç njoh-



jes mirë të Kuranit dhe Sunetit, në të njëjtën kohë duhet të njohë mirë edhe rrymat filozofike, sepse vetëm kështu mund të mbrohet populli nga rreziku që mund të vijë nga ideologjitë e gabuara filozofike. Nga ky këndvështrim, mund të themi që është obligim për ta. Në asnjë mënyrë nuk duhet lënë kjo çështje në duart e filozofëve ateistë dhe materialistë. Prandaj është një konsekuencë e natyrshme për çdo mysliman cilësor që, duke i verifikuar mendimet filozofike me anë të Islamit, t'i diferencojë të drejtat nga gabimet.

**Imam Gazali** për të mbrojtur besimin e njerëzve nga idetë e gabuara, e mirëstudioi filozofinë. Madje, për të qenë i mbrojtur nga akuza “njeriu është armik i së panjohurës”, u thellua shumë në lëmin e filozofisë. Pasi shkroi veprën “*Qëllimi i filozofëve*”, ku trajton me detaje të gjitha problemet dhe çështjet filozofike të kohës, shkroi veprën “*Inkonsekuenca e inkonsekuencës*”, në të cilën kritikon filozofët dhe filozofinë. Ai në këtë vepër kritikoi 20 pika të filozofëve, të cilat binin ndesh me besimin, ku tre prej tyre përbënin herezi.

Një tjetër problem që ka sjellë filozofia, është përpjekja e disa pseudofilozofëve dashamirë dhe admirues të filozofisë perëndimore, për ta bazuar mendimin islam mbi themele filozofike. Kjo është një përpjekje tinëzare për të vendosur arsyen mbi shpalljen hyjnore.



Mirëpo, Islami nuk ka nevojë për sintezë me asnjë sistem njerëzor, me asnjë kohë, me asnjë rrymë dhe me asnjë fe tjetër. Tendenca e bërjes së këtyre sintezave, vjen si pasojë e mosnjohjes si duhet e madhësisë së Islamit. Sepse Islami është feja e vetme e vërtetë dhe origjinale në rruzullin tokësor. Kur ajo është njohur dhe praktikuar si duhet, është bërë burim lumturie dhe qetësie për shoqëritë perspektive.

Pretendimi se bukuria e këndimit të bilbilit qëndron në bashkëshoqërimin e krakëllimave të korbit, është injorancë e theksuar dhe shumë qesharake njëkohësisht.

Rektori i universitetit islamik të Roterdamit, **Prof. Dr. Ahmet Akgyndyz**, në artikullin e tij “*Në kërkim të rregullit të ri botëror dhe qytetërimi islam*”, rreth faktit që Islami është i vetmi botëkuptim që mund t’i sigurojë njerëzimit qetësinë dhe lumturinë, bën këto evidentime.

*“Në periudhën kur komunizmi dhe kapitalizmi dhe të tjera “izma” kanë dështuar plotësisht, alternativa e vetme dhe serioze, e cila mund t’i sigurojë qetësinë botës është Islami.*

*Një shembull konkret i kësaj të vërtete janë vendimet e marra në një mbledhje të fshehtë në Romë nga priftërinjtë. Priftërinjtë pranuan faktin se 60% e të rinjve që janë shkëputur nga komuniz-*



*mi nuk dëshirojnë kthimin në doktrinën e krishterë, por shikojnë Islamin si gjetjen e duhur të tyre.*

*Sikur ne myslimanët ta jetojmë dhe ta përçojmë siç duhet Islamin, numri i myslimanëve në Evropë do të rritej në mënyrë marramendëse.*

*Perëndimorët, të frikësuar nga kjo, po përpiqen me gjithë qenien e tyre për t'ua paraqitur të shtrembëruar Islamin brezave të ri.*

*Asnjë shoqëri nuk mund të jetojë pa besim. Në Rusi, ku komunizmi pothuajse e çrrënjosi plotësisht fenë nga zemrat e njerëzve, kthimi i njerëzve në krishterim shihet si i pamundur. Nëse ne e bëjmë detyrën tonë siç duhet, atëherë zgjedhja e tyre do të jetë Islami.”*

Propaganda negative që është bërë ndër shekuj kundër Islamit dhe fanatizmi i tepruar i pengon perëndimorët të shikojnë diellin islam.

Përpjekjes dhe propagandës së tyre shekullore për të errësuar dritën e Islamit duke e paraqitur **Islamin si fe barbare dhe fisnore**, i ka zënë vendin fushata për ta paraqitur **Islamin si fe e terrorizmit** dhe luftës. Kurse varfërinë, luftën, anarkinë, prapambetjen dhe gjendjen e mjerueshme të vendeve myslimane e tregojnë si argument të pretendimeve të tyre.

Ata i fshehin masës së gjerë të popullit rolin që kanë luajtur për të krijuar këtë panoramë të botës islame, me qëllim për të zbatuar planet e tyre kolo-



nizatore mbi botën islame. Por sot, në epokën e informacionit, ku është më e vështirë për ta fshehur të vërtetën është shtuar numri i atyre që e shikojnë dhe pranojnë të vërtetën.

Një person, i cili studion përmbajtjen e botëkuptimit islam larg paragjykimeve, është e pamundur të mos ndikohet dhe të mos shikojë të kundërtën e atyre që pretendojnë që Islami është fe e terrorit dhe luftës. Sepse jeta e **Pejgamberit** ﷺ, i cili është dërguar si mëshirë për njerëzimin ka kaluar plot 23 vjet duke luftuar terrorizmin. E gjithë jeta e Tij ka qenë një përpjekje për të zhdukur terrorin ndaj njeriut, kafshëve dhe natyrës. Ai i përhap gjithë njerëzimit mëshirë, drejtësi dhe barazi.

Njëri ndër themeluesit ideologjikë të Revolucionit Francez, filozofi **Lafajet**, më 1789 para shpalljes së “Deklaratës së të drejtave të njeriut”, kishte studiuar dhe shqyrtuar me kujdes dhe përpikëri të gjitha sistemet juridike dhe duke parë lartësinë dhe epërsinë e të drejtës islame, vlerësimin dhe admirimin e tij ndaj Pejgamberit ﷺ, e shprehu kështu:

*“O Muhamed! Atë që ti ke sjellë dhe aplikuar në botë, nuk e ka bërë askush tjetër. Ti e ke sjellë drejtësinë në një shkallë të paarritshme!..”*

Ekzistojnë fjalë të tilla vlerësuese të shumë mendimtarëve perëndimorë të cilët, megjithëse jomyslimanë, kanë mundur të shmangen nga anti-patia e sëmurë.



Në të vërtetë, ardhja e Pejgamberit ﷺ, në periudhën e plotë të injorancës, ku shoqëria ishte zhytur në imoralitet, idhujtari dhe mosbesim ishte një rilindje dhe burim lumturie për njerëzimin.

Ai përmes mësimëve, edukatës dhe moralit e shndërroi atë panoramë gjakatare dhe të egër, ku vajzat varroseshin të gjalla, ku grindjet e vogla fisnore ktheheshin në lumenj gjaku në kopsht të qetësisë, paqes dhe lumturisë.

Nga atmosfera e armiqësisë fisnore, gjakmarrjes, padrejtësisë dhe grindjeve u kalua në atmosferën e vëllazërisë, paqes, mirëkuptimit, solidaritetit dhe ndihmës reciproke. Në këtë mënyrë, u ndërtua qytetërimi i virtyteve, të cilin sot e kësaj dite e ka zili gjithë njerëzimi.

Islami është një dritë udhëzimi, i cili kur zbatohet në jetë e lartëson shoqërinë në kulmin e njerëzisë, virtyteve dhe qytetërimit. Njerëzimi nuk ka dhe nuk ka për të pasur sistem tjetër më të mrekullueshëm dhe të përkryer, i cili mund t'i sigurojë qetësinë dhe lumturinë përveç Islamit...

Prandaj është detyrë e çdo myslimani ta përfaqësojë siç duhet, me gjithë hijeshinë dhe madhësitinë e vet Islamin, i cili përfaqëson fenë e vetme të vërtetë dhe origjinale në rruzullin tokësor.

Nuk ka absurditet më të madh se sa admirimi që kanë disa persona myslimanë për botëkuptimet





jashtë Islamit, në një kohë kur shoqëritë që ndjekin këto botëkuptime janë të zhytura në një krizë shpirtërore, psikologjike, morale dhe sociale të thellë.

Këtu dëshiroj të citoj një fjalë të politikanit dhe filozofit të njohur francez **Roger Garaudy**, i cili para se të konvertohej në mysliman, ka qenë shefi i byrosë së partisë komuniste franceze. Pasi u bë mysliman, erdhi për një konferencë në Stamboll, ku ndër të tjera tha:

*“Ju për nga feja dhe ideologjia jeni të përkryer, kurse perëndimi është i sëmurë. Interesant është fakti që ju ndiqni të sëmurin dhe jeni krejtësisht të pavetëdijsëm për gjendjen tuaj të përsosur!..”*

Një tjetër shfaqje e kësaj dukurie është përpjekja për të kritikuar Islamin përmes optikës së filozofisë në fakultetet teologjike, të cilat duhet të shërbejnë për të mësuar shkencat islame dhe për t'i vlerësuar botëkuptimet dhe rrymat e tjera filozofike në këndvështrimin Islam. Fatkeqësisht, fakultetet teologjike, nga një vatër e lulëzimit të shkencave dhe diturisë islame, janë shndërruar në vende debatesh dhe diskutimesh rreth temave dhe çështjeve të padobishme filozofike.

Për më tepër që mësimi i filozofisë dhe rrymave të saj pa pasur një bazë dhe formim të fortë të shkencave themelore islame, është shumë i rre-



zikshëm, sepse mund të lëndojë rëndë principin e Tevhidit, mbi të cilin qëndron i gjithë botëkuptimi islam. Është gabim i pafalshëm për profesorët e teologjisë orientimi i studentëve nga filozofia dhe rryma të tjera të gabuara, pa mësuar mirë themelet e fesë islame. Sepse jo të gjithë studentët janë të aftë të dallojnë mangësitë dhe problemet e botëkuptimeve të tjera.

Prandaj, përveç ndonjë rasti sporadik, është shumë e vështirë të gesh një mysliman, i cili është bërë më i devotshëm dhe i përkushtuar ndaj fesë duke mësuar filozofi. Por ka plot raste të njerëzve, të cilët janë ftohur dhe larguar nga feja për shkak të zhytjes në filozofi, pa pasur njohuritë e duhura rreth Islamit.

Nëse është i nevojshëm mësimi i filozofisë, ajo duhet mësuar pasi të merren njohuritë themelore mbi Kuranin dhe Sunetin dhe duke u vlerësuar sipas kritereve kuranore dhe profetike. Studentëve u duhet shpjeguar dhe argumentuar pikëpamja e Islamit mbi botën, në të njëjtën kohë u duhen mësuar edhe përgjigjet që jep Islami kundër tezave materialiste dhe ateiste. Vetëm në këtë mënyrë ata do të kuptojnë që i vetmi botëkuptim që kënaq ndjenjat dhe arsyen dhe që i siguron njeriut lumturinë në këtë botë dhe botën tjetër, është botëkuptimi islam.

Shkollat tradicionale përgatitnin dijetarë të mirëfilltë, të aftë për të udhëzuar dhe orientuar shoqërinë



në çdo fushë. Një dijetar, pasi thellohet në shkencat themelore si Kuran, hadith, tefsir, akaid dhe fikh, sipas prirjeve të tij mund të mësojë filozofi, mjekësi, sociologji etj.

Kurse sistemi arsimor i sotëm është larg një synimi të tillë, synimi i tij është profilizimi dhe thellimi në një degë të caktuar. Me keqardhje vërejmë që shumë studentë të fakulteteve teologjike mbarojnë shkollën pa u pajisur as me njohuritë themelore rreth Kuranit dhe Sunetit.

Lënda “**Jeta e Profetit ﷺ**”, e cila është e një rëndësie të veçantë për sa i përket interpretimit të Kuranit dhe Sunetit, ka shumë pak vend në programin mësimor të fakulteteve teologjike. Për më tepër që edhe trajtimi që bëhet nuk kalon përtej dhënies së njohurive kronologjike mbi jetën e Pejgamberit ﷺ.

Mirëpo, mësimi dhe analizimi i jetës së të Dërguarit të Allahut ﷺ, është i domosdoshëm, sepse Ai është modeli shembullor për të gjitha aspektet e jetës njerëzore.

Allahu në çdo rekat të namazit na urdhëron të lutemi për udhëzim dhe qëndrim në rrugë të drejtë.

إِهْدِنَا الصِّرَاطَ الْمُسْتَقِيمَ

**Udhëzoni në rrugën e drejtë.** (Fatiha, 6)

Kurse rrugën e drejtë mbi të cilën kërkohet ecja jonë, e regjon në suren Jasin, e cila, duke iu referuar



Pejgamberit ﷺ, thotë:

عَلَى صِرَاطٍ مُسْتَقِيمٍ

“Në të vërtetë ti je në rrugë të drejtë.” (Jasin, 4)

Ndjekja e rrugës së Pejgamberit ﷺ, është obligim për çdo person që dëshiron të ndjekë rrugën e drejtë dhe rrugën me të cilën Allahu është i kënaqur.

Burimet kryesore të myslimanëve janë Kurani dhe jeta shembullore e Pejgamberit ﷺ. Kurani përfshin parimet, kurse zbërthimi dhe zbatimi i tyre gjendet në jetën e Pejgamberit ﷺ. Kjo është arsyeja që Allahu në Kuran urdhëron:

مَنْ يُطِعِ الرَّسُولَ فَقَدْ أَطَاعَ اللَّهَ

“Kush i bindet të Dërguarit, i është bindur Allahut.” (Nisa, 80) Kurse në një ajet tjetër thotë:

وَإِنَّكَ لَعَلَى خُلُقٍ عَظِيمٍ

“Me të vërtetë, ti je me virtyte të mëdha.”

(Kalem, 4)

Të gjithë ata që janë në kërkim të moralit të përsosur, duhet të përpiqen të ndjekin dhe të marrin për model moralin e Pejgamberit ﷺ. Prej 1400 vjetësh të historisë islame, të gjitha veprat dhe literaturat islame kanë trajtuar një libër, Kuranin dhe një njeri, **Pejgamberin** ﷺ, si modelin e gjallë të moralit të Kuranit.



نَزَلَ بِهِ الرُّوحُ الْأَمِينُ \* عَلَى قَلْبِكَ لِتَكُونَ  
مِنَ الْمُنذِرِينَ \* بِلِسَانٍ عَرَبِيٍّ مُبِينٍ \*

**“Atë e zbriti Shpirti i besueshëm (Xhebraili) në zemrën tënde (o Muhamed), që të jesh nga ata që paralajmërojnë. E zbriti në gjuhën e qartë arabe.”** (Shuara, 193-195)

Për një besimtar që dëshiron të mësojë dhe kuptojë Kuranin, nuk ka rrugë dhe mënyrë tjetër përveç përfshirjes së tij në atmosferën shpirtërore dhe morale të Pejgamberit ﷺ, sepse 23 vjet të jetës profetike të Pejgamberit ﷺ, kanë qenë në rolin e interpretimit, shpjegimit dhe zbatimit të Kuranit. Zbulimi i urtësive dhe sekreteve të Kuranit, është i mundur vetëm përmes ndjekjes, bindjes dhe përtjetimit të atmosferës shpirtërore të Tij.

Nga kjo pikëpamje, kuptimi dhe mësimi i jetës së Pejgamberit ﷺ, përbën shkallën e parë të ibadetit ndaj Allahut.

Pa kuptuar, pa njohur, pa ndjekur dhe pa u përfshirë në botën e Tij shpirtërore, nuk është i mundur as besimi i plotë, as kuptimi i Kuranit dhe as kryerja e ibadetit siç duhet...

**Pa njohur siç duhet jetën e Pejgamberit ﷺ, nuk është i mundur kuptimi i asnjë shkence islame; as tefsirit, as hadithit, as fikhut, dhe**



**as moralit. Prandaj, për të kuptuar siç duhet Islamin, i duhet dhënë një rëndësi e madhe mësimet të jetës së Profetit ﷺ.**

Allahu në Kuran jep shpeshherë shembuj, duke theksuar cilësitë dalluese të tyre. Kurani kërkon prej nesh të reflektojmë dhe analizojmë zgjidhjet që i kanë dhënë ata problemeve, me të cilat janë përballur në shoqëritë përkatëse. Nga ky këndvështrim, është e domosdoshme që krahas lëndës Historia e feve, të studiohet edhe historia e profetëve në fakultetet teologjike.

Studentët që studiojnë shkencat islame, së pari duhet të përvetësojnë si duhet njohuritë themelore të Islamit, pastaj mund të profilizohen në një degë të caktuar apo të studiojnë edhe në fusha të tjera të shkencave.

Studentët që do të studiojnë shkencat islame, së pari duhet të forcojnë themelet e Islamit. Në të kundërt, ata do të shemben përballë çdo furtune që mund të vijë nga botëkuptimet e tjera. Ky është shkaku kryesor që shumë të rinj po përfshihen nga vorbullat e mendimit dhe filozofisë perëndimore.

**Allahu na mundësoftë të kuptojmë dhe vlerësojmë siç duhet Kuranin dhe Sunetin e Pejgamberit ﷺ, në mënyrë që zemra dhe mendja jonë të ushqehet nga këto dy burime.**

**Allahu na bëftë prej atyre që ndjejnë madhësh-**



tinë e Allahut në Kuran, në natyrë dhe tek njeriu.

Allahu na dhëntë një zemër dhe mendje, e cila çdo gjë në natyrë, në Kuran dhe në krijesat e vlerëson brenda suazave të ajetit: “*Lexo me emrin e Zotit tënd, i Cili krijoi (gjithçka)*”.

Amin!..



# PËRMBAJTJA

PARATHËNIA.....	7
FILOZOFIA DHE ARSYEJA NË KËNDVËSHTRIMIN ISLAM.....	15
NJË PIKË NGA OQEANI.....	18
MISTERE HYJNORE QË NGJALLIN ADMIRIM.....	20
PESHORE E SAKTË.....	24
KËRKIMI I LUMTURISË NË VENDE TË GABUARA.....	26
SEKRETI I QETËSISË ËSHTË PËRPPJEKJA DHE MBËSHTETJA TEK ALLAHU.....	29
ARSYEJA E MILINGONAVE.....	33
PËR ÇFARË SHËRBEN ARSYEJA MBASI TË IKËN ANIJA?.....	37
NEVOJA E KRITERIT PRAKTIK.....	42
SIKUR TË MJAFTONTE ARSYEJA.....	47
SIKUR RRUGA E ARSYES TË ISHTE NJË.....	51
POZITIVIZMI, SIMBOL I ABSURDITETIT.....	54
ARSYEJA, NJË THIKË ME DY PRESA.....	60
EKLIPSI I ARSYES.....	62
CILA ARSYE?.....	68
MENDJA E SHËNDOSHË.....	71
SEKRETI I QETËSISË SHPIRTËRORE ËSHTË URTËSIA.....	73





KRAHËT E SHPIRTIT.....	80
SAKRIFIKIMI I ARSYES PËRBALLË SHPALLJES.....	83
PASQYRA E SË VËRTETËS.....	85
DEVIJIMET AKADEMIKE.....	88



